

Për 24 orë shtatë
persona vdesin nga
Covidi në Kosovë FAQE 7



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", FERAT SHALA FAQE 4-5

DISA VEPRIME TË QEVERISË HOTI BIEN NDESH ME KONCEPTIN E SHOQËRISË SONË



Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ferat Shala, ka dhënë kritika për qeverinë aktuale. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se disa veprime të qeverisë Hoti bien ndesh me konceptin e shoqërisë sonë. "Qeveria aktuale e ka humbur rugën ende pa filluar punën", është

shprehur Shala, duke theksuar se shuarja e Taskës Forcës antikorupsion është goditje ndaj politikave të përgjithshme të luftës globale kundër korrupsionit. Ai ka thënë se qeveria Hoti nuk ka treguar vullnet që të arrijë një kompromis sa i përket Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike. "PDK-ja është partia e parë nga subjektet e tjera politike që ka ofruar

paketën për rimëkëmbje ekonomike. Kjo paketë e PDK-së për rimëkëmbje ekonomike është injoruar skajshmërisht nga institucionet e shtetit", ka thënë Shala, i cili në këtë intervistë ka folur edhe për ndërmarrjen "Trepça". Ai ka pohuar se "Trepça" nuk mund të mbahet dhe zhvillohet me borde të përkohshme politike

AKTUALE



PDK-ja PROPOZON OFRIMIN E TRANSPORTIT PUBLIK PA PAGESË NË KRYEQYTET F. 6

SOT MBLIDHET KUVENDI, VAZHDON SEANCA E SË ENJTES F. 7

MKRS-ja JEP MBËSHTETJE PËR 167 TË RINJ PËRFITUES PËRMES GRANTEVE PËR START-UP F. 6



EKONOMI

SI PËRFUNDUAN "TREPÇA" DHE TELEKOMI I KOSOVËS ME LLOGARI TË BLOKUARA? F. 9

PAPUNËSIA NË BE ËSHTË RRITUR 7.5 PËR QIND F. 8

KULTURË

BASRIE MURATI-SAKIRI SHËNON PREZANTIMIN E 11-të TË LIBRIT "BLEIBENDE SPUREN" F. 15



SPORT

THELLOHET KRIZA E LLAPIT DHE E PRISHTINËS F. 15



SHTOHEN KRITIKAT NDAJ PROCESIT TË DIALOGUT KOSOVË - SERBI FAQE 3


DIALOGU ME SERBINË PO E HUMBET KUPTIMIN

Është shtuar mosbesimi në suksesin e procesit të dialogut me Serbinë. Përveç opozitës, edhe zyrtarët e partisë që udhëheqin qeverinë po mendojnë se

ky proces ka filluar ta humbë kuptimin. Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka vlerësuar se ky proces po shndërrohet në instrument të Serbisë për të blerë

kohë. Edhe zyrtarët e opozitës mendojnë se procesi i Brukselit është duke e humbur kuptimin për fajin e Serbisë dhe të BE-së

SHTOHET DHE SHTRIHET NË TERRITOR FUSHATA PRESIDENCIALE NË SHBA FAQE 2



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjiibiznesi.com
info@kolegjiibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Nëntë viktima dhe 327 persona me Covid-19 në Shqipëri

TIRANË, 1 NËNTOR (ER) - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Shqipëri ka njoftuar se në 24 orët e fundit kanë humbur jetën nëntë qytetarë dhe janë konfirmuar edhe 327 raste të reja me Covid-19. Në 24 orët e fundit janë shëruar 57 qytetarë, duke e çuar numrin e të shëruarve në 11 246 që nga fillimi i epidemisë. “Gjatë 24 orëve të fundit janë kryer 1 472 testime, nga të cilët kanë rezultuar pozitivë 327 qytetarë të prekur nga virusi SARS-COV2. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u bën thirrje qytetarëve të mos e ulin vigjilencën për zbatimin e masave antiCovid, por ta ruani distancën fizike me persona që nuk janë familjarët tuaj, të kujdeseni për higjienën

personale dhe ta mbani maskën në ambientet jashtë shtëpisë”, është bërë me dije në njoftimin e kësaj ministrie.

Rastet pozitive të konfirmuara në 24 orët e fundit janë identifikuar në këto bashki: 152 raste në Tiranë, 25 në Durrës, 14 në Lezhë, 12 në Mirditë, nga 11 raste në Korçë, Elbasan, 10 në Kavajë, 9 në Gjirokastrë, nga 7 raste në Shkodër, Lushnjë, Berat, nga 5 raste në Kukës, Tropojë, nga 4 raste në Devoll, Mallakastër, Përmet, Gramsh, nga 3 raste në Fier, Kurbini, Vlorë, Librazhd, Ura Vajgurore, Fushë Arrëz, nga 2 raste në Pukë, Dibër, Prrenjas, Kuçovë, nga 1 rast në Krujë, Kamëz, Pogradec, Tepelenë, Roskovec, Bulqizë, Peqin, Klos, Skrapar, Cërrik.



Shtohet dhe shtrihet në territor fushata presidenciale në ShBA

WASHINGTON, 1 NËNTOR - Dy ditë para zgjedhjeve, presidenti Donald Trump dhe ish-nënpresidenti Joe Biden janë përqendruar te shtetet fushëbetë, të nevojshme për ta fituar garën presidenciale. Dy kundërshtarët po ashtu po mbështeten në fushatat e tyre nga figura të profilit të lartë, në përpjekjet për t'i ofruar argumentet përmbyllëse të fushatës dhe për t'i nxitur amerikanët të votojnë.

Presidenti Trump ka qëndruar të dielën në pesë shtetet vendimtare, Miçigan, Ajova, Karolinën e Veriut, Florida dhe Xhorxhia.

Ish-nënpresidenti Joe Biden ka bërë fushatë në shtetin e tij të vendlindjes, Pensilvani. Në Miçigan të shtunën, një shtet që Trumpi e fitoi me rezultat të ngushtë katër vjet më parë, ish-presidenti Obama iu bashkua për herë të parë fushatës së Bidenit. Thirrja e kandidatit demokrat Joe Biden për votuesit ishte: “Ne



zgjedhim shpresën përballë frikës. Unitetin përballë ndarjes, shkencën përballë trillimeve. Ne zgjedhim të vërtetën përballë gënjeshtërve të njëpasnjëshme”.

Gjatë katër tubimeve në Pensilvani, presidenti Trump paralajmëroi se ekonomia do të rrënohej nën administratën e Bidenit. “Joe Biden do të mbyllë ekonominë, do t'i

dërgojë vendet tuaja të punës në Kinë, e cila e paguan atë shumën më të madhe. Do t'i rrisë taksat me 4 trilionë dollarë dhe do ta çojë vendin në një depresion të thellë katastrofik”,

ka thënë Trump.

Kurse bashkëshortja e tij, Melania Trump, tha: “Donald lufton për t'i mbrojtur dhe mbështetur të gjithë amerikanët. Kemi një president që mbështet rendin dhe ligjin. Një president që mbështet plotësisht gratë dhe burrat në uniformë, ndërsa të tjerët bëjnë thirrje për shkurtimin e fondeve të tyre. Kemi besim te gjykatësit dhe sistemi ligjor për të marrë vendime të mbështetura te drejtësia”, është shprehur ajo. Ndërkohë më shumë se 90 milionë amerikanë kanë votuar deri tani, një pjesëmarrje rekord, me radhë të gjata në Nju-Jork, Oklahoma, Florida dhe Xhorxhia. “Çdo votë ka vlerë”, thotë një votues.

Zyrtarët në disa shtete po u kërkojnë amerikanëve që personalisht t'i dorëzojnë fletët e votimit në qendrat e caktuara në mënyrë që ato të arrijnë brenda afatit kohor. /VOA/

Izolimi në Britani mund të zgjasë më shumë se një muaj

LONDËR, 1 NËNTOR - Një pjesëtar i kabinetit qeverisës në Britani ka paralajmëruar se masat e mbylljes, që janë paralajmëruar se do të jenë në fuqi për katër javë, mund të zgjasin më gjatë,

teksa edhe shtetet e tjera evropiane po aplikojnë masa të reja për ta frenuar përhapjen e koronavirusit.

Kryeministri britanik Boris Johnson tha se shteti i tij do të

hyjë në izolim nga 5 nëntori dhe kjo masë do të zgjasë për një muaj.

Qytetarët britanikë do të mund të dalin nga shtëpia vetëm për të blerë gjëra të nevojshme dhe

nëse iu duhet trajtimi mjekësor. Johnson ka thënë se këto masa duhej të vendoseshin, pasi Britania kaloi shifrën prej 1 milion të infektuarish me koronavirus.



Shtohen kritikrat ndaj procesit të dialogut Kosovë - Serbi

Dialogu me Serbinë po e humbet kuptimin



Është shtuar mosbesimi në suksesin e procesit të dialogut me Serbinë. Përveç opozitës, edhe zyrtarët e partisë që udhëheqin qeverinë po mendojnë se ky proces ka filluar ta humbë kuptimin. Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka vlerësuar se ky proces po shndërrohet në instrument të Serbisë për të blerë kohë. Edhe zyrtarët e opozitës mendojnë se procesi i Brukselit është duke e humbur kuptimin për fajin e Serbisë dhe të BE-së

EPOKA ERE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Dialogu me Serbinë ka filluar të shihet me skepticizëm edhe nga partia më e madhe e koalicionit qeverisës, Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK). Lideri i kësaj partie, Isa Mustafa, ka bërë me dije se për shkak të sjelljes së Serbisë dhe të Bashkimit Evropian (BE), procesi i dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit është duke e humbur kuptimin. Sipas tij, ky proces po “shndërrohet në instrument të Serbisë për të blerë kohë për t’i vënë në harresë krimet e saj. “Me sjelljet e Serbisë, në njërën anë dhe të BE-së, në

anën tjetër, dialogu po e humbet kuptimin. Sa po rrjedh koha, ai më shumë po shndërrohet në instrument të Serbisë për të blerë kohë për t’i vënë në harresë krimet e saj. Kosova e vlerësoi fjalimin e një deputeti shqiptar në Parlamentin e Serbisë. Ai e tha të vërtetën! Por ne dëgjuam edhe betimin e çdo ministri serb, të tjerë, përveç serbëve, nuk ka në ‘demokracinë serbe’, se ‘do të jem i përkushtuar për ruajtjen e Kosovës e Metohisë brenda Republikës së Serbisë’”, ka shkruar Mustafa në llogarinë e vet në “Facebook”. Ai ka vlerësuar se Kosova është treguar konstruktive në këtë proces, duke shtuar se ky

përkushtim nuk është vlerësuar sa duhet nga BE-ja. “Shtrohet pyetja si konvergjon dialogu për marrëveshje gjithëpërfshirëse që rezultojnë me njohje reciproke me këtë zotim të qeverisë serbe! A mund BE-ja ta japë shpjegimin e saj? Kosova është treguar konstruktive karshi dialogut dhe angazhimit të BE-së dhe ShBA-së për këtë proces. Edhe kryeministri Hoti po tregon përkushtim shumë konstruktiv. Por ky përkushtim i yni, kam përshtypje se nuk po vlerësohet nga BE-ja. Bile ka tendenca të hapen disa tema që janë të njëjtat me ato që janë diskutuar në procesin e Vjenës. Ndërkaq, Kosova e ka

shpallur pavarësinë me mbylljen e atyre temave në ‘Pakon e Ahtisarit’”, ka shkruar Mustafa. Ai është shprehur kritik ndaj BE-së edhe për procesin e liberalizimit të vizave. “Kundërshtimi i vendeve të caktuara të BE-së për liberalizimin e vizave për qytetarët e vendit tonë, edhe pse janë përmbushur të gjitha kriteret, më shumë flet për një qëndrim paragjykses të tyre sesa për parime. Ne kemi dëshirë të besojmë se vendet e tilla ia duan të mirën Kosovës. Por kjo ide nuk pasqyrohet përmes politikave të izolimit të qytetarëve të një vendi. Politikat e izolimit nuk përkrijnë me demokracinë dhe

kulturën evropiane. Ndërkaq ne nuk heqim dorë nga të qenit evropianë, me territor, me arsim, me kulturë dhe me ekonomi. As vizat dhe as Serbia nuk na ndalin në këtë rrugë”, ka vlerësuar Mustafa. Pothuajse të njëjtin mendim ka edhe opozita. Deputetja e PDK-së, Blerta Deliu, mendon se në këtë proces një pjesë të fajit e kanë vendet e BE-së. “Disa shtete të Evropës janë duke e parë dialogun si shans për ta ‘rikuperuar gabimin me Serbinë’! Pavarësinë dhe shtetin e Kosovës duket se e konsiderojnë padrejtësi ndaj Serbisë dhe kjo vërehet edhe në propozimet për zgjidhjen e konfliktit mes Kosovës e Serbisë. Cenimi i karakterit unitar të Kosovës është tendencë për t’i krijuar celulat e destabilizimit të funksionimit shtetëror të Kosovës”, ka shkruar Deliu-Kodra në llogarinë e vet në “Facebook”. Sipas saj, në këtë proces BE-ja po vazhdon ta trajtojë Kosovën si palë jo e barabartë. “Në anën tjetër, me mungimin e lirisë së lëvizjes vetëm për kosovarët, Evropa demonstroi hapur mosgatishmërinë për ta pranuar popullin e Kosovës të barabartë me popujt e tjerë të Evropës. Populli i Kosovës është më proevropian në rajon sepse beson në vlerat e proklamuar të saj por, si duket, Kosova mbetet e përjashtuar nga këto vlera. Kosova është shteti më i ri i Evropës dhe Evropa duhet ta pranojë në familjen e saj, duke filluar me hapjen e dyerve për qytetarët kosovarë”, ka shkruar ajo. Qeveria e Kosovës, që udhëhiqet nga kryeministri Avdullah Hoti, insiston që Kosova në dialog me Serbinë shkon vetëm për një marrëveshje finale e cila do të kishte në vete njohjen reciproke.

Viktima të tërmetit në Turqi janë edhe dy persona me prejardhje nga Kosova

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Dy qytetarë në Izmir, me prejardhje nga Kosova, janë në mesin e viktimave nga tërmeti i fuqishëm që goditi Turqinë dhe Greqinë më 30 tetor. Ndërkaq Ambasada e Kosovës në Ankara ka konfirmuar se dy persona nga familja Dograyan në Izmir kanë vdekur si pasojë e tërmetit. “Mund të konfirmojmë se deri më tani

nuk ka të dhëna për shtetas të Republikës së Kosovës të vdekur”, thuhet në një postim të ambasadës në llogarinë e saj në “Facebook”. Autoritetet turke kanë konfirmuar se të paktën 35 persona kanë vdekur në Izmir, ndërkaq autoritetet greke kanë thënë se dy persona kanë vdekur në ishullin grek Samos.

Tërmeti, që ndodhi më 30 tetor në detin Egje, ishte 7 shkallë të Rihterit, ka njoftuar Shërbimi Gjeologjik i Shteteve të Bashkuara. Ekipet e shpëtimit në Izmir po vazhdojnë punën për t’i nxjerrë të mbijetuarit e tjerë që gjenden nën rrënoja. Sipas autoriteteve turke, 180 persona vazhdojnë të jenë të bllokuar nën rrënojat e ndërtesave të shkatërruara.





Flet për “Epokën e re”, Ferat Shala

DISA VEPRIME TË QEVERISË HOTI BIEN NDESH ME KONCEPTIN E SHOQËRISË SONË

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ferat Shala, ka dhënë kritika për qeverinë aktuale. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka theksuar se disa veprime të qeverisë Hoti bien ndesh me konceptin e shoqërisë sonë. “Qeveria aktuale e ka humbur rrugën ende pa filluar punën”, është

shprehur Shala, duke theksuar se shuarja e Taskë Forcës antikorrupsion është goditje ndaj politikave të përgjithshme të luftës globale kundër korrupsionit. Ai ka thënë se qeveria Hoti nuk ka treguar vullnet që të arrijë një kompromis sa i përket Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike. “PDK-ja është partia e parë nga subjektet e tjera politike që ka ofruar

paketën për rimëkëmbje ekonomike. Kjo paketë e PDK-së për rimëkëmbje ekonomike është injoruar skajshmërisht nga institucionet e shtetit”, ka thënë Shala, i cili në këtë intervistë ka folur edhe për ndërmarrjen “Trepça”. Ai ka pohuar se “Trepça” nuk mund të mbahet dhe zhvillohet me borde të përkohshme politike

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 1 NËNTOR -

“Epoka e re”: Z. Shala, si e vlerësoni punën e qeverisë meqë u shfaqën mospajtime edhe brenda këtij koalicioni sa i përket shuarjes së Taskë Forcës?

Shala: Qeveria aktuale e ka humbur rrugën ende pa filluar punën. Praktikisht sot kemi disa veprime të saj që bien ndesh me konceptin e shoqërisë sonë, në të cilin më shumë mund është tentuar të

ndërtohet një shtet dhe po tentohet që të ndërtohet shtet i së drejtës dhe i ligjit kundër korrupsionit. Në parim hapat e parë kjo qeveri i ka në goditjen e institucioneve të Kosovës që shteti ynë është munduar t'i ndërtojë përmes luftës kundër korrupsionit. Prandaj goditja e Taskë Forcës është goditje e drejtpërdrejtë që iu bëhet forcave të shëndosha në luftën kundër korrupsionit. Të gjithë mekanizmat ndërkombëtarë dhe vendorë janë pajtuar që të kemi një mekanizëm institucional i cili do ta luftojë

dhe ta çrrënjosë korrupsionin. Tani qeveria i goditë këta mekanizma. Tash shtrohet pyetja: Se ku do të na dërgojë ky koncept?, që është një gabim i madh strategjik, të cilin të tillë janë duke e konsideruar edhe partnerët tanë dhe zyra të caktuara të shteteve të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kjo në një farë forme është goditje edhe ndaj politikave të përgjithshme të luftës globale kundër korrupsionit. Ka dhjetëra raste që institucionet tona nuk janë

aktive në luftën kundër korrupsionit, por kemi vetëm pjesë demagogjike që bëhet. Në anën tjetër, asnjë veprim konkret zhvillimor apo social nuk e shohim përkundër një situatë në të cilën gjendemi. Shikoni, as ligjet thelbësore pandemisë nuk po kalojnë. E gjithë kjo, në saje të mosangazhimit të institucioneve qeveritare për të pasur një koordinim dhe për të nxjerrë legjislacion të mirëfilltë.

“Epoka e re”: Pse PDK-ja nuk është duke e votuar Ligjin për

Rimëkëmbje Ekonomike?

Shala: PDK-ja është partia e parë nga subjektet e tjera politike që ka ofruar paketën për rimëkëmbje ekonomike. Kjo paketë e PDK-së për rimëkëmbje ekonomike është injoruar skajshmërisht nga institucionet e shtetit. Qeveria aktuale nuk e ka vënë në diskutim paketën tonë ekonomike, por ajo ende mundohet të bëjë paralelizëm me një ligj jo të mirë. Atëherë si mund ta votojmë në këtë ligj? Parimisht deri më tani kjo qeveri nuk ka pasur vullnet e as



dije që të marrë mundin dhe të gjendet një kompromis për të mirën e ekonomisë së Kosovës, pra për ndërmarrësit dhe për kategoritë sociale që janë goditur nga pandemia Covid.

“Epoka e re”: *Sa i përket mosvotimit për heqje të homologimit, në opinion qarkullojnë zëra se PDK-ja është e kapur nga “Devolli”. Po ashtu, kishte thirrje nga OEK-u që mos të votohet heqja e homologimit për shkak të ambientit.*

Shala: Spekulumet nuk dua t'i interpretoj. Ne po presim që ligji për automjete të vijë sa më shpejt në Kuvend, pra të shohim se si ka mundësi të bëhet një ligj i mirëfilltë i cili e rregullon këtë fushë. Personalisht mendoj se Kosovës i duhet një ligj i mirëfilltë që disiplinon këtë sferë në shumë pika, jo vetëm te homologimi, por edhe të pjesa tjetër që nga hyrja e automjeteve, menaxhimi i tyre, bartja e pronësisë, pastaj çështja e automjeteve të vjetra që janë brenda Kosovës dhe automjeteve të paregjistruara, veçanërisht pjesa që lidhet me çështjen e sigurisë së automjeteve në fushën e komunikacionit. Kjo problematikë nuk zgjidhet për inate politike, qoftë nga pozita apo opozita. Kjo problematikë është në interes të përgjithshëm të vendit dhe duhet të debatohet hapur në mënyrë që ta përmirësojmë gjendjen e sigurisë në

komunikacion, gjithashtu edhe situatën e hapjes së tregut. Ta liberalizojmë tregun dhe ta zbusim deri në minimum mundësinë e rrezikut në komunikacion.

“Epoka e re”: *“Trepçës” i janë bllokuar xhirollogaritë për shkak të borxheve ndaj kreditorëve. Ndërkohë që keni thënë se dora e shtetit s’është vërejtur në këtë industri në kohë pandemie. Nga pikëpamja juaj, si duhet të veprohet me këtë aset?*

Shala: Me “Trepçën” edhe qeveria e mëhershme, edhe kjo e tanishmja kanë bërë lojëra politike. Është rasti i dytë me shkarkim të bordeve të përkohshme. Qeveria Kurti e shkarkoi bordin e rregullt dhe e vendosi një bord të përkohshëm. Tani qeveria Hoti e shkarkon bordin e përkohshëm të qeverisë Kurti dhe vendos një bord të përkohshëm të kësaj qeverie. Do të duhej të punonin me logjikën ekonomike, shkencore dhe ligjore, sepse në dy mandate nuk po arrihet zgjedhja e një bordi të rregullt. “Trepça” nuk mund të mbahet dhe zhvillohet me borde të përkohshme politike. E aq më keq që bordi i deritashëm ishte i paligjshëm, sepse nuk ka pasur kuorum. Të gjitha vendimet që bordi i përkohshëm i qeverisë Kurti ka marrë, kanë qenë shkelje e paligjshme me pasoja të mëdha për ekonominë dhe “Trepçën”. Tani kemi të njëjtën logjikë me aktorë të njëjtë që luajnë me bordin tjetër të përkohshëm. Tani shtrohen këto pyetje: Pse nuk zgjedhet bordi i rregullt në ndërmarrjet publike, veçanërisht në “Trepçë”? Kush është duke penguar qeverinë që ta zgjedhë një bord të rregullt? Pse me kohë nuk ka vazhduar procedura e rregullt? Ka disa muaj që “Trepça” është pa bord të rregullt dhe tani nuk ka mjete financiare për paga të punëtorëve? Kujt po i konvenon kjo krizë sociale që po përgatitet në “Trepçë”? Pse po luhet me kategorinë më të ndershme dhe më sociale? Këto janë disa pyetje që qeveria Hoti do të duhej të jepte përgjigje. Bllokohet për 7 000 euro kontoja e një ndërmarrje që ka mbi 1 300 punëtorë. Është një krizë e thellë institucionale dhe minerare e atyre që menaxhojnë sot institucionet e Kosovës dhe “Trepçën”. Në asnjë rast dhe në asnjë paketë financiare qeveria Hoti nuk e ka paraparë subvencionimin dhe zgjidhjen e problemeve të “Trepçës” dhe të minatorëve dhe ndërmarrjeve industriale. Ne patëm në raportim ministrin e Industrisë dhe Tregtisë dhe asnjë cent kjo qeveri nuk ka ndarë si rezultat i kushteve të rënda nga pandemia. Pra, është një anashkalim që kjo qeveri e ka bërë me qëllim për “Trepçën”.

MINISTRI LIKAJ BËN THIRRJE QË TË RESPEKTOHEN REKOMANDIMET E EKSPERTËVE SHËNDETËSORË

PRISHTINË, 1 NËNTOR (ER) - Ministri i Arsimit dhe i Shkencës, Ramë Likaj, ka kërkuar që të respektohen rekomandimet e ekspertëve shëndetësorë për mbrojtje nga koronavirusi pasi, siç ka thënë ai, “asnjë skenar tjetër nuk e zëvendëson pjesëmarrjen në shkollë”. “U bëjmë thirrje nxënësve, prindërve, mësimdhënësve dhe stafit të shkollave, që të respektojnë në përpikëri masat e rekomanduara nga MSh dhe IKShPK. Asnjë skenar tjetër nuk e zëvendëson pjesëmarrjen në shkollë. Prandaj, të punojmë të gjithë së bashku që ta mbajmë në jetë skenarin A (mësim me pjesëmarrje në shkollë). Falënderoj të gjithë nxënësit,

prindërit, mësimdhënësit, taskforcat, DKA-të, Kolegjiumin e DKA-ve, Asociacionin e Komunave, Ministrinë e Shëndetësisë, IKShPK-në, Policinë e Kosovës, SBAShK-un, inspektoratet përkatëse dhe të gjithë që po na ndihmojnë që ta kalojmë sa më lehtë këtë situatë pandemike”, ka bërë me dije ministri Likaj. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës në Kosovë ka paraparë që në këtë vit shkollor mësimi të realizohet përmes tre skenarëve. Skenari A ka të bëjë me zhvillimin e mësimi në ambientet shkollore. Skenari B, apo mësimi i kombinuar përfshin rikthimin e pjesshëm të nxënësve në shkolla (prani e

nxënësve në shkolla, e kombinuar edhe me mësimin në distancë) dhe skenari C është mësimi në distancë apo online. Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO), Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF) dhe Banka Botërore kanë bërë thirrje që shkollat nëpër botë të qëndrojnë të hapura gjatë pandemisë të shkaktuar nga koronavirusi. Në një raport të lëshuar më 28 tetor, të tri këto organizata thanë se në kulmin e “mbylljes” për shkak të pandemisë, më shumë se 1.5 miliard fëmijë u prekën nga mbyllja e shkollave që, sipas tyre, shkaktoi një krizë globale të mësimi të paprecedentë.



“Epoka e re”: *Pasi që qeveria i ka 80 për qind të aksioneve, a do të duhej që të ketë privatizim në këtë pjesë që i takon meqë secila qeveri është duke e përdorur si kartë?*

Shala: Ndoshta është një tendencë për t'ia ulur vlerën

“Trepçës”. Kjo po bëhet pikërisht nga qeveria aktuale. “Trepça” nuk mund të privatizohet duke ia ulur vlerën. Ka mekanizma që kanë për ta shpërfaqur kundërshtinë në raport me këtë punë. Ne duhet të bisedojmë për forma

të partneritetit apo zhvillimit, por jo të privatizimit, sepse aktualisht jemi në procesin e hetimit të ndërmarrjeve në Kosovë dhe duhet ta bëjmë një freskim të kaluarës sonë dhe ta shohim si është privatizuar dhe kush ka përfituar.

PDK-ja propozon ofrimin e transportit publik pa pagesë në kryeqytet

**EPOKA
ERE****Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Zyrtarë të Partisë Demokratike të Kosovës në Prishtinë kanë mbajtur konferencë për media, në të cilën kanë propozuar që të mundësohet transporti publik pa pagesë prej muajit nëntor deri në muajin mars për shkak të nivelit të lartë të ndotjes së ajrit në kryeqytet dhe përhapjes së virusit Covid-19.

Asamblistja e PDK-së, Suzana Vuqitërna-Kika, ka thënë se për vite me radhë Prishtina është renditur si qyteti i parë në botë me ndotjen më të madhe të ajrit. “Ka një javë që vlerat e matësve të ajrit të vendosur në qytet tregojnë se ai është i pashëndetshëm. Jua rikujtoj që mbajtja e maskave për qytetarët e Prishtinës ka qenë ritual i zakonshëm sa herë kanë rënë temperaturat edhe para përhapjes së pandemisë Covid-19, pikërisht për shkak të ndotjes së ajrit. E këtë vit gjendja duket të jetë edhe më e rënduar. Një numër gjithnjë e më i madh njerëzish të ekspozuar ndaj ndotjes së rëndë të ajrit vuajnë nga sëmundje të identifikuara si sëmundje që rrisin ndjeshmërinë ndaj Covid-19. Personat me probleme kronike të mushkërive dhe zemrës të shkaktuara ose të përkeqësuar nga ekspozimi afatgjatë ndaj ndotjes së ajrit, në përgjithësi

janë më të prekshëm nga sëmundjet sekondare, siç janë gripi ose infeksionet. Dy faktorët kryesorë në lidhje me Covid-19 janë rreziku i marrjes së sëmundjes më shpejt sesa personat e shëndetshëm, dhe rreziku i shfaqjes së një reaksioni më të rëndë kur merret sëmundja. Prandaj, ulja e ndotjes së ajrit mund të ndihmojë në uljen e ashpërsisë së virusit”, ka thënë Vuqitërna-Kika.

Nënkryetari i PDK-së në Prishtinë, Ilirik Musliu, ka thënë se PDK-ja në Prishtinë, duke e parë që qytetarëve po iu kanoset edhe një rrezik tjetër shëndetësor, ai i përhapjes së sëmundjeve respiratore, ka menduar një zgjidhje me efekt të menjëhershëm, por që është edhe afatgjatë: ofrimin e shërbimeve të transportit publik falas nga muaji nëntor deri në muajin mars për të gjithë qytetarët e Prishtinës. “Nga analizat që kemi bërë, kjo do të ishte zgjidhja më efikase. Në studimet e fundit gjatë një dite në orën 10 të paradites, me një incizim satelitor është konstatuar se në qytetin e Prishtinës ishin 120 000 vetura të pranishme në trafik, pa i llogaritur ato që kanë qenë të parkuara brenda në garazhe. Pra, brenda ditës në Prishtinë hyjnë dhe dalin prej 70 000 - 100 000 vetura, të cilat emetojnë gazra ndotës në ambient. Nëse secila nga to shpenzon vetëm



dy litra derivate brenda qytetit, atëherë imagjinojeni sa litra derivate shpenzohen brenda qytetit në vetëm një ditë. Përveç emetimit të gazrave ndotëse, imagjinojeni shumën e parave që shpenzohen në derivate. Meqenëse bileta e autobusit

aktualisht kushton 0.40 centë për një drejtim, pra 0.80 centë për vajtje-ardhje dhe familjet tona i kanë mesatarisht katër anëtarë, atëherë i bie që një familje të shpenzojë 3 euro e 0.20 centë brenda një dite për transport publik ose 96 euro

brenda një muaji apo 384 euro për katër muaj”, ka deklaruar Musliu.

PDK-ja në Prishtinë konsideron se implementimi i këtij projekti shkarkon trafikun e kryeqytetit, mbron ambientin, kursen kohën dhe xhepin e qytetarëve.

MKRS-ja jep mbështetje për 167 të rinj përfitues përmes granteve për start-up



PRISHTINË, 1 NËNTOR (ER) - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në bazë të vendimit nr. 903/2020, në thirrjen publike për mbështetje financiare publike për rritjen e punësimit përmes granteve start-up, ka bërë vlerësimin e aplikacioneve të pranuar nga aplikuesit dhe ka përzgjedhur gjithsej 167 përfitues. Këto aplikime kanë ardhur si rrjedhojë e trajnimeve që MKRS-ja ka mbështetur në fushën e ndërmarrësisë për të rinj, ku të rinjtë pas trajnimeve për ndërmarrësi kanë pasur mundësi që pastaj të aplikojnë për grante të ndryshme përmes thirrjes publike të hapur nga

MKRS. Në komplet fushën e ndërmarrësisë janë trajnuar 755 të rinj në trajnime profesionale për përgatitje për treg të punës, 500 për trajnime në ndërmarrësi. Numri i të rinjve të trajnuar e ka tejkaluar numrin e paraparë prej 400 sa parashihej duke shkuar në 1255. Ky është numri më i madh i granteve start-up që ka përkrahur MKRS-ja ndonjëherë. Ministria Dumoshi me këtë rast ka uruar të gjithë përfituesit, duke u shprehur e lumtur që si ministri kanë arritur të përkrahin kaq shumë të rinj dhe të kontribuojnë në ngritjen e tyre profesionale.

Ukë Berisha rizgjedhet kryetar i PShDK-së për mandatin e tretë katërvjeçar

PRISHTINË, 1 NËNTOR (ER) - Partia Shqiptare Demokratike e Kosovës (PShDK) ka mbajtur Kuvendin Zgjedhor, në të cilin me shumicë absolute

kryetari i deritashëm Ukë Berisha është rizgjedhur në postin e kryetarit të kësaj partie. Kuvendi është përcjellë dhe

monitoruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) dhe votimi është bërë sipas saj dhe rregullave të IKShPK-së.

Nga 201 delegatë të pranishëm, Berisha mori 118 vota. Ky është mandati i tretë i Ukë Berishës në PShDK.



Sot (e hënë) fillon zbatimi i masave të reja anti Covid

Për 24 orë shtatë viktima nga Covidi në Kosovë

Prej 1 318 testimeve për Covid-19, pozitiv kanë dalë 337 persona në Kosovë. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka bërë me dije se brenda 24 orëve të fundit kanë vdekur shtatë persona dhe janë shëruar 91 pacientë. Nga sot (e hënë) Kosova do ta nisë zbatimin e masave të reja anti Covid, të cilat parashohin që qendrave tregtare dhe gastronomisë t'u ndalohet puna nga ora 21:00-05:00 (përveç shërbimeve "merr me vete")



Kosova, masa të reja kundër Covidit

Nga sot (e hënë) Kosova do të vendosë masa të reja për ta frenuar përhapjen e mëtejme të Covidit. Ministri i Shëndetësisë në Qeverinë e Kosovës, Armend Zemaj, ka deklaruar se vendimi për masat e reja vjen pas rritjes së numrit të rasteve të infektimit me Covid-19. Këto janë masat e reja: Qendrave tregtare dhe gastronomisë u ndalohet puna nga ora 21:00-05:00 (përveç shërbimeve "merr me vete"); Ndalohej seminarët, punëtoritë dhe format e tjera të organizimit ku ka

grumbullim njerëzish/mbahen on-line; Personat me sëmundje kronike dhe ata mbi moshën 60 vjeçare lirohen nga paraqitja në punë/punojnë on-line nga shtëpia; Personave mbi moshën 65 vjeç u lejohet dalja jashtë shtëpisë nga ora 06:00-10:00 dhe nga 16:00-19:00; Ligjëratat në universitete publike dhe private mbahen on-line. Provimet, puna praktike dhe laboratorike mbahen me prani fizike duke respektuar rekomandimet e MSh/IKShPK; Konviktet dhe Mensa e

Studentëve punojnë duke zbatuar rekomandimet e IKShPK. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë masat do të rishikohen pas dy jave. Shoqata e Gastronomisë i ka kundërshtuar këto masa, duke i quajtur ndërhyrje të shtetit në ekonomi. Shoqata e Gastronomeve e Kosovës ka paralajmëruar një mbledhje të jashtëzakonshme për të hënë në orën 14:00, ku do të vendosë lidhur me hapat e ardhshëm që do të ndërmerren ndaj masave të reja.

Sot mblidhet Kuvendi, vazhdon seanca e së enjtes

PRISHTINË, 1 NËNTOR (ER) - Kuvendi i Kosovës mblidhet sot (e hënë) për ta vazhduar punën me pikat e seancës së kaluar. Në rend dite janë shtatë pika të mbetura nga seanca e së enjtes. "6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 07/L-021 për të Drejtat Pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës; 7. Shqyrtimi i Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2020-2024; 8. Debat parlamentar lidhur me problemet e banorëve shqiptarë në veri të Mitrovicës dhe komunave të tjera në pjesën veriore të Kosovës lidhur me pengesat që u bëhen për t'u kthyer në pronat e tyre dhe pengesat për renovimin e shtëpive të djegura gjatë luftës; 9. Kërkesa e Komisionit Hetimor

Parlamentar lidhur me procesin e licencimit, operimit, mbikëqyrjes dhe aplikimit për lejet e hidrocentraleve në Republikën e Kosovës për miratimin e buxhetit të këtij Komisioni Hetimor; 10. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Auditimit për vitin 2019; 11. Debat parlamentar në lidhje me vazhdimin e Qeverisë së Serbisë që ta mbajë të fshehur të vërtetën për fatin e mbi 1 600 civilëve shqiptarë, të rrëmbyer nga ky shtet gjatë luftës gjenocidare në Kosovë, që ende konsiderohen të zhdukur; 12. Debat parlamentar në lidhje me sensibilizimin dhe masat që duhet të ndërmerren nga qeveria dhe institucionet përgjegjëse në luftën kundër kancerit të gjirit", ka njoftuar Kuvendi i Kosovës.



Veseli kërkon nga qeveria t'i ndihmojë vreshtarinë dhe prodhimtarinë



RAHOVEC, 1 NËNTOR (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka vizituar disa vreshtari dhe prodhimtari të verës në Komunën e Rahovecit. Gjatë vizitës te vreshtat e Eqrem Hoxhës dhe te dy bodrumet e verës, “Illyrians & Murati” dhe “Bodrumi i Vjetër”, kryetari Veseli u ka dhënë mbështetjen e tij

këtyre prodhuesve dhe i ka siguruar ata se do të punojë që kërkesat e tyre të dëgjohen. Në këtë kontekst, Veseli i ka bërë thirrje edhe qeverisë që këto prodhimtari të ndihmohen me më shumë fonde dhe subvencione gjatë kësaj periudhe të vështirë të pandemisë. “Këta po e bëjnë

punën e tyre. Po punojnë dhe po prodhojnë. Prandaj, edhe qeveria duhet që ta bëjë punën e vet dhe të ndihmojë këta njerëz punëtorë përmes fondeve dhe subvencioneve”, ka deklaruar Veseli. Më tutje, kryetari Veseli ka kërkuar nga qytetarët të konsumojnë sa më shumë

prodhime vendore, sidomos gjatë kësaj periudhe, në mënyrë që të ndihmohen edhe më shumë prodhuesit vendor. “E kemi për obligim gjithmonë, në veçanti gjatë kësaj periudhe, që të gjithë ne të konsumojmë më shumë produkte vendore.”, ka thënë kryetari Veseli. Ndërsa Ruzhdi Haxhijaha, pronar

i “Bodrumit të Vjetër”, ka falënderuar kryetarin Veseli për vizitën dhe mbështetjen e pakursyer që u ka bërë gjithmonë prodhuesve vendorë. Ai ka thënë se konsumimi i produkteve vendore është goditur shumë nga pandemia, megjithatë, me punë dhe vetëmohim, janë duke ia dalë të mbijetojnë me vështirësi.

Qytetarët e Kosovës kanë rreth katër miliardë euro kursime

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Edhe në Kosovë është shënuar Dita Botërore e Kursimeve. Kjo ditë është krijuar për ta rritur ndërgjegjësimin e publikut për rëndësinë e kursimeve si për ekonominë moderne, po ashtu edhe për individët. Kursimet janë të rëndësishme në ekonominë globale dhe çdo depozitues kontribuon në zhvillimin e tyre. Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka thënë se kanë bërë shumë punë që të ketë rritje të vetëdijesimit për kursime. “Ne kemi bërë marrëveshje me Ministrinë e Arsimit për ta pasur edukimin financiar në shkollat e



Kosovës dhe kjo është shumë me rëndësi. Librat që i kemi botuar janë në katër gjuhë, po ashtu kemi

edhe librat me zë”, ka thënë Mehmeti në televizionin publik. Ai u ka bërë ftesë fëmijëve të aplikojnë

në konkursin për ese në lidhje me kursimet. “Ideja është e kësaj eseje që fëmijët të lexojnë sadopak për kursim dhe menaxhimin e parasë”, është shprehur Mehmeti. Më tutje, Mehmeti ka thënë se sistemi bankar është një ndër shtyllat kryesore në ekonominë e Kosovës. Për situatën në të cilin gjendet Kosova, në këtë kohë pandemie, Mehmeti ka thënë se kjo pandemi ka pasur ndikim të madh. “Diaspora është duke kontribuar në Kosovë. Vetëm ardhja nga Zvicra e dërgimtarëve kontribuoi pozitivisht”, ka deklaruar ai. Guvernatori Mehmeti ka thënë se qytetarët e Kosovës kanë kursime

deri në katër miliardë euro. “Bankat nuk kanë nevojë të marrin mjete nga jashtë, pasi kanë depozita të mjaftueshme”, është Mehmeti, duke kërkuar nga bankat që ta përmirësojnë ofertën për kredi. “Ne kemi koordinim të mirë me bankat. Ne kemi marrë masa që ta ruajmë stabilitetin financiar”, është shprehur Mehmeti. Sipas tij, BQK-ja gjatë kohës së pandemisë ka marrë veprime e vendime që kanë bërë që të ketë lehtësira për qytetarët e vendit. Ai ka thënë se një ndër vendimet ka qenë edhe ai për kreditë, konkretisht për shtyrje të tyre. “Pritjet tona kanë qenë që të kemi rritje të kredive të këqija”, ka thënë Mehmeti.

Papunësia në BE është rritur 7.5 për qind

BRUKSEL, 1 NËNTOR - Shkalla e papunësisë në Bashkimin Evropian (BE) është rritur në 7.5 për qind në shtator apo me 0.9 pikë përqindjeje nga viti në vit. Siç ka njoftuar Zyra e Statistikave të BE-së, në mes të pandemisë Covid-19 shkalla e papunësisë

ka vazhduar të rritet për 6 muaj rresht si në BE ashtu edhe në Eurozonë. “Shkalla e papunësisë në Eurozonë po ashtu është rritur me 0.8 pikë përqindjeje në 8.3 për qind në muajin e fundit me bazë vjetore”, ka njoftuar

Eurostat. Eurostat ka treguar se gati 16 milionë burra dhe gra në vendet e BE-së, përfshirë 13.6 milionë në Eurozonë, janë të papunë që nga muaji shtator. Numri i personave të papunë është rritur me 42 mijë në bazë mujore dhe

1.8 milion në vit në shtator, në bllokun me 27 anëtarë. Shkalla më e lartë e papunësisë u shënuar në Greqi me 16.8 për qind, Spanjë me 16.5 për qind dhe Itali me 9.6 për qind dhe më të ulëtat në Çeki me 2.8 për qind dhe Poloni me 3.1 për qind.



Si përfunduan “Trepça” dhe Telekom i Kosovës me llogari të bllokuara?

Borxhet e akumuluar ndë vite kanë bërë që të bllokohen xhirollogaritë e “Trepçës” dhe Telekomit të Kosovës. Telekom i Kosovës i ka borxh mbi 25 milionë euro kompanisë “Z-Mobile” për shkak të mospërbushjes së një kontrate nga ana e Telekomit. Ndërsa ndërmarrja “Trepça” ka një borxh prej rreth pesë milionë eurosh ndaj KEDS-it dhe operatorëve të tjerë

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Dy kompanitë më të mëdha në Kosovë, Telekom i Kosovës dhe “Trepça”, gjatë javës kaluar kanë përfunduar me llogari bankare të bllokuara për shkak të borxheve të akumuluar ndë vite. Telekom i Kosovës i ka borxh mbi 25 milionë euro kompanisë “Z-Mobile” për shkak të mospërbushjes së një kontrate nga ana e Telekomit. Ndërsa ndërmarrja “Trepça” ka një borxh prej rreth pesë milionë euro ndaj Distribucionit të Furnizimit me Energji Elektrike (KEDS) dhe operatorëve të tjerë. Qeveria e Republikës së Kosovës, e cila është pronare e 100 për qind të aksioneve të Telekomit dhe 80 për qind e aksioneve të “Trepçës”, është duke bërë përpjekje që të gjendet një zgjidhje për të tejkaluar këtë situatë, por që deri më tani nuk ka ndonjë plan konkret. Qeveria e Kosovës ka konsideruar se “Trepça” ka trashëguar kontrata të pafavorshme të cilat po i shkaktojnë dëme financiare. Për të dalë nga kjo situatë, kryeshefi i “Trepçës”, Hysen Vrajolli, ka thënë se Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit është duke bashkëpunuar me Bordin dhe Menaxhmentin e “Trepçës”, për ta përgatitur panin e biznesit për tejkalim të situatës. Viti 2018, nga Qeveria e Kosovës që atëbotë udhëhiqej nga Ramush Haradinaj, ishte shpallur vit i kompleksit metalurgjik “Trepça”, që nënkuptonte

rifunksionalizimin e ndërmarrjes. Por, kjo ndërmarrje, e cila llogaritej si një prej ndërmarrjeve më të mëdha jo vetëm në Kosovë, por edhe në ish-Jugosllavi, asnjëherë që nga paslufta nuk ka arritur të vihen në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit. Aktualisht, “Trepça” merret me nxjerrjen dhe përpunimin e mineraleve, kryesisht të plumbit dhe zinkut dhe është e vetmja prodhuese e këtij lloji në Kosovë. Por, prodhimi është shumë i ulët dhe atë vetëm rreth 150 mijë tonë xehe në vit, ndërsa në periudhën para vitit 1999 miniera prodhonte rreth 600 mijë tonë xehe në vit. Gjatë këtij viti kryeshefi i “Trepçës”, Hysen Vrajolli, ka thënë se ka pasur rritje të prodhimit për rreth 30 për qind krahasuar me vitin e kaluar, por rënia e çmimeve në bursa dhe tregje ndërkombëtare e ka nxjerrë këtë kompani me afarizëm negativ. “Trepça”, e cila në vitet ’80 punësonte mbi 20 mijë punëtorë, aktualisht ka 1 400 punëtorë, të cilët pas bllokimit të llogarive mund të mbesin edhe pa paga. Vrajolli ka thënë se pret që llogaria bankare e “Trepçës” të zhbllokohet gjatë javës së ardhshme, ndërsa për të dalë nga kjo krizë në të cilën është futur “Trepça”, ai ka thënë se iu duhen pesë milionë euro ndihmë nga qeveria. Kombinati “Trepça” gjendet në



Komunën e Mitrovicës. Sektorët e tij gjenden në pjesën veriore dhe atë jugore të qytetit. “Trepça” sot brenda Kosovës përbëhet prej 41 njësive të ndryshme, që grupohen kryesisht në tri komplekse të mëdha: në miniera me flotacione, në parkun industrial në Mitrovicë dhe në kompleksin e shkretoreve. Por, një pjesë e madhe e këtyre kapaciteteve janë të degraduara për shkak të mungesës së mirëmbajtjes ose mungesës së investimeve, madje edhe keqshfrytëzimit në të kaluarën. Përveç aseteve në Kosovë, 31 prona të këtij kombinati gjenden në republikat e ish-Jugosllavisë, duke përfshirë këtu fabrika, zyra dhe objekte të tjera.

Rrezikohen të ndërpriten të gjitha shërbimet e telefonisë

Ngjashëm si punëtorët e “Trepçës”, edhe mbi 2 500 punëtorë të Telekomit të Kosovës rrezikohen të mbesin pa paga. Në mungesë të mjeteve, përveç pagave, Lamih Balaj, kryetar i Federatës Sindikale të Telekomit të Kosovës, ka thënë se

rrezikohen të ndërpriten të gjitha shërbimet e telefonisë mobile dhe fiks. Për të mos ndodhur kjo, Qeveria e Kosovës, ka thënë Balaj, është e vetmja ajo e cila duhet ta nxjerrë Telekomin nga kjo situatë në të cilën ka hyrë. Bllokimi i llogarive të Telekomit të Kosovës nga një përmbarues privat është bërë për të dytën herë brenda tre muajve. Në korrik, pas takimeve që kishin pasur përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit me kompaninë “Z-Mobile”, llogaritë ishin zhbllokuar. Qeveria e Kosovës, siç ka thënë Balaj, edhe tani është duke zhvilluar takime në mënyrë që të gjendet një zgjidhje. Ndryshe, Telekom i Kosovës ishte një kontribuues i fuqishëm i buxhetit të vendit. Për çdo vit kjo kompani i ka sjellë arkës së shtetit miliona euro. Nga viti 2008 deri në vitin 2015 kjo kompani i ka paguar Qeverisë së Kosovës mbi 250 milionë euro dividendë. Dividendi, sipas ligjit, ndahet në rast se kompania përkatëse shënon rezultate të mira financiare. Telekom i Kosovës është kompani publike, e transformuar në shoqëri aksionare, në të cilën operon telefonia fikse dhe ajo

mobile “Vala”. Operatori “Vala” ka mbi 1.2 milion konsumatorë në nivel vendi. Marrëveshja e vitit 2009 me “Dardafon.net LLC” është konsideruar si kontratë e dëmshme, e cila, përveç të tjerash, thuhet se e ka futur në krizë financiare Telekomin e Kosovës. Kjo kompani është e njohur me emrin tregtar “Z-Mobile”. Kjo kontratë i kishte mundësuar kompanisë “Z-Mobile” të ishte operator virtual i telefonisë mobile të operatorit mobil “Vala”, që funksionon në kuadër të Telekomit të Kosovës. Kontrata në vazhdimësi është konsideruar si e dëmshme por, si e tillë, ka zgjatur deri në korrik të vitit 2019, kur bordi i Telekomit të Kosovës pati marrë vendim për shkëputjen e saj. Pavarësisht prej fitimeve që “Z-Mobile” është thënë t’i ketë pasur nga kjo kontratë, kompania ka pretenduar se Telekom i Kosovës nuk e ka përmbushur kontratën në tërësi dhe e kishte paditur, ku edhe ka fituar rastin. Telekom i Kosovës për dëmin e shkaktuar ndaj kompanisë “Z-Mobile”, obligohet të paguajë një gjobë mbi 25 milionë euro, për të cilat mjete edhe janë bllokuar llogaritë bankare të Telekomit.

Telekom i Kosovës kërkon ndihmë nga qeveria dhe partitë politike

PRISHTINË, 1 NËNTOR (ER) - Telekom i Kosovës ka kërkuar ndihmë nga Qeveria e Kosovës, pas bllokimit të mjeteve nga “Dardafon.net”. Zyrtarë të Telekomit kanë kërkuar nga ekzekutivi dhe partitë politike që ta ndihmojnë këtë ndërmarrje për kthimin e mjeteve. Menduh Abazi, drejtor i Departamentit për Relacion me Publikun në Telekom, në një konferencë për media ka thënë se gjithçka është kthyer në pikën zero, ku tashmë llogaritë bankare janë bllokuar dhe kanë filluar të tërhiqen paratë. “Edhe pse është paralajmëruar se marrëveshja është finalizuar dhe

ka pasur të ndodhë vetëm akti ceremonial i nënshkrimit të marrëveshjes”, ka thënë Abazi. Ai ka thënë se punëtorët janë të rebeluar sepse kanë pritur t’i marrin pagat. “Ka brenda një rebelim të punëtorëve për shkak se kanë pritur që t’i marrin pagat. Ne kemi qenë duke bashkëpunuar me qeverinë dhe kemi bërë plane konkrete për rimëkëmbje të Telekomit. Goditja që ka ndodhur ka kthyer gjithçka në pikën zero. Ne presim përkrahje nga qeveria e të gjitha partitë politike”, ka thënë Abazi. Më tutje, Abazi ka thënë se Telekom i Kosovës është mbështetur për



muri dhe nuk mund të bëjë asgjë më shumë sesa që ka bërë deri

më tash. “Me atë që ka ndodhur, jemi totalisht të bllokuar ku do të

bien të gjitha shërbimet”, është shprehur Abazi.

Ferizaj synon binjakëzimin me një qytetet të Iowas

FERIZAJ, 1 NËNTOR - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka biseduar me kryetarin e Bashkisë së Cedar Falls në Iowa të ShBA-së, Robert Green, me të cilin janë pajtuar që ta thellojnë bashkëpunimin kulturor, sportiv dhe ekonomik. Aliu ka bërë me dije se ka marrë dritën e gjelbër për nisjen e procesit të binjakëzimit të

Ferizajt me Cedar Falls. “Pas bisedës që pata me kryetarin e Bashkisë së Cedar Falls në Iowa të ShBA-së, z. Robert Green, me lehtësimin edhe të konsullit të Kosovës në Iowa, Artan Duraku, u pajtuam t’ua japim mundësinë dy qyteteve tona të lidhin bashkëpunim kulturor, sportiv dhe ekonomik. Dje nisma për

binjakëzimin e Ferizajt dhe Cedar Falls mori dritën e gjelbër e vulën edhe të Kuvendit të Komunës. Faleminderit anëtarëve të Kuvendit për mbështetjen! Ferizaj së shpejti nis bashkëpunimin e parë me një qytet përtej Atlantikut, me këtë rast me Cedar Falls në Iowa-ShBA”, është shprehur Aliu.



Përrurohet një park i ri në Prizren



PRIZREN, 1 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka dhe drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Osman Krasniqi, së bashku me përfaqësuesit e OJQ “Ec ma ndryshe”, kanë bërë përrurimin e parkut të ri në lagjen “Lakuriq”. Me këtë rast, kryetari Haskuka ka

deklaruar se ndihet i gëzuar që tanimë edhe kjo lagje do të ketë një ambient rekreativ për të gjithë banorët, e sidomos për fëmijët, të cilët tashmë kanë hapësira si këndi i lojërave, fusha e futbollit e të basketbollit. Duke deklaruar se do të vazhdojnë të krijojnë ambiente dhe hapësira të reja të gjelbra e rekreative,

kryetari Haskuka u ka bërë thirrje qytetarëve që t’i mbrojnë dhe të kujdesen për ta. Ndërsa drejtori Krasniqi, duke falënderuar OJQ-në “Ec ma ndryshe”, për këtë projekt të përbashkët me komunën, u shpreh se me këtë organizatë do të vazhdojnë të punojnë edhe për realizimin e projekteve të tjera.

Përrurohet fusha sportive në lagjen “Te Polonicët”

PODUJEVË, 1 NËNTOR (ER) - Nënkyetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, i shoqëruar nga drejtoresha e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Donika Sfishta, ka bërë përrurimin e fushës sportive në lagjen “Te Polonicët” në Podujevë. Nënkyetari Rudari ka thënë se Komuna e Podujevës do të

vazhdojë të investojë për krijimin e kushteve të mira për zhvillimin e aktiviteteve sportive në secilin lokalitet të Podujevës. Ai ka bërë me dije se këtë javë do të përrurohen fusha sportive në fshatin Sfeçël. Komuna e Podujevës është duke zhvilluar punimet për ndërtimin e terreneve sportive edhe në pesë lokalitete të tjera.




Rregullohet ndriçimi publik në rrugën Bubavec - Kijevë

MALISHEVË, 1 NËNTOR (ER) - Ka përrfunduar rregullimi i ndriçimit publik në rrugën “Imer Krasniqi”, përkatësisht në segmentin e rrugës që lidhë fshatrat Bubavec dhe Kijevë. Në lëshimin në funksion të dritave në këtë rrugë ishin të pranishëm drejtori komunal për Urbanizëm, Ahmet Morina dhe anëtarët e KK të Malishevës, Sylë Dukolli dhe Kajtaz Gashi.

Drejtori Morina i ka uruar banorët e dy fshatrave, duke thënë se “kjo rrugë ka rëndësi të madhe, e ndriçimi do të krijojë siguri të madhe për banorët, në veçanti për nxënësit e kësaj pjese”. Rregullimi i ndriçimit në këtë rrugë është pjesë e projektit komunal për rregullimin e ndriçimit në të gjitha vendbanimet e Komunës së Malishevës dhe mundësohet nga buxheti i komunës.



Basrie Murati-Sakiri shënon prezantimin e 11-të të librit ‘Bleibende Spuren’



BERN, 1 NËNTOR - Basrie Murati-Sakiri, me prejardhje nga Kosova, vazhdon paraqitjen e librit të saj, të shkruar në gjuhën gjermane, “Bleibende Spuren” (“Gjurmë të përhershme”). Libri është botuar vitin e kaluar nga shtëpia botuese “Rotpunktverlag” https://rotpunktverlag.ch/buecher/bleibendespueren?fbclid=IwAR1RcmJe0_6so_qsKnXi1Bu0NUED

m0x5O_sfNX21kzh1iE_X07oD1-uBv8A, njëra nga më të njohurat në Zvicër.

Kësaj radhe autorja Murati-Sakiri librin e ka paraqitur para nxënësve të klasave të 10-ta të shkollës “Rudolf Steiner Schule” të Ittigenit, kantoni i Bernit.

Duke qenë se subjekti i librit janë përpjekjet e autores, si nxënëse 18-vjeçare e gjimnazit në Besianë

(shtator 1988 - maj 1989) dhe shoqeve e shokëve të saj, që Kosova ta fitojë lirinë dhe statusin e Republikës, prezantimi i librit si dhe bashkëbisedimi i saj me nxënësit u fokusua në kohën dhe shkaktarët e politizimit të saj; lindjen e nacionalizmit në ish-Jugosllavi; Titon; veprimtarinë politike të saj; sfidat në mërgim (qershor 1989- 2019) si dhe

raportet e saj tani me atdheun. Millosheviqi, përkatësisht politika e tij karshi popujve të tjerë, kanë qenë, po ashtu, pashmangshëm në fokusin e interesimit të nxënësve. “Millosheviqi ka qenë nacionalist. E njëjta vlen edhe për bashkëpunëtorët dhe politikën e tij. Ai ka kryer krime. Ishte kriminel! I tillë do të qe për mua edhe po të ishte shqiptar!”, ka qenë

vlerësimi i autores rreth figurës së Slobodan Millosheviqit. “Si pasoja të dukshme të luftës së tij dhe Serbisë kriminale”, ka shtuar më tej ajo, “kemi gjenocidin, të vrarët, të dhunuarat, të pagjeturit shqiptarë në Kosovë”. Prezantimi në Ittigen u mbajt në kuadër të lëndës së Historisë, me tematikë: “Shkatërrimi i ish-Jugosllavisë”.


Adriana Matoshi fiton çmimin ‘Aktorja më e mirë’ në Festivalin e Filmit në Valencia të Spanjës

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Adriana Matoshi ka fituar një çmim tjetër ndërkombëtar për kinematografi. Ndonëse tashmë dihet se filmi “Zana” e ka ndihmuar Adriana Matoshin të depërtojë në festivale ndërkombëtare, aktorja nga Kosova e ka marrë çmimin “Aktorja më e mirë” në festivalin “Mostra de Valencia”.

Ndërsa “Lavanguardia” ka shkruar një artikull për fituesit e festivalit, duke dhënë lajmin për fitoren e aktores Adriana Matoshi si “Aktorja më e mirë”. Lajmin e ka bërë me dije Qendra Kinematografike e Kosovës në faqen e vet në “Facebook”, duke e quajtur atë triumfuese në këtë festival.



Muaji nëntor i Anton Çetës



PRISHTINË, 1 NËNTOR (ER) - Qeveria e Kosovës ka miratuar propozimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që muaji nëntor të quhet “Muaji i Anton Çetës”.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka theksuar se ky muaj duhet të quhet kështu për shkak të kontributit që ka dhënë veprimtari Anton Çeta.

Në këtë muaj do të bëhet përkujtimi i veprave të Anton Çetës, përkujtimi i Kullës së Fazli Buqollit në Raushiq (investim i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit); këndi i Anton Çetës - ekspozitë në Muzeun Kombëtar të Kosovës; emisione televizive - RTK, shfaqja e emisionëve dhe dokumentarëve të vjetër dhe punimi i një dokumentari të ri;

simpozium shkencor në Prishtinë dhe Tiranë; ekspozitë e fotografive në Prishtinë dhe Tiranë, Muzeu Kombëtar i Kosovës dhe Muzeu Historik në Tiranë; dhe Themelimi i Çmimit “Anton Çeta”. “Ky propozim miratohet meqenëse viti 2020 shënon 100-vjetorin e lindjes dhe 25-vjetorin e vdekjes së prof. Anton Çetës, intelektualit të ndritur, mbledhësit të shquar të folklorit, shkrimtarit të njohur e pajtuesit të palodhur të gjaqeve. Njëkohësisht, viti 2020 shënon 30-vjetorin e paktimit të gjaqeve, kthesës historike mbarëpopullore në Kosovë e jashtë saj, që i kontribuoi zhdukjes së hasmërive dhe shërimit të shoqërisë shqiptare e paktimit mes njerëzve”, është bërë me dije në njoftimin për media.



Suzanne Conklin Akbari: A mundet eseja të na befasojë sërish?

Kur isha rreth katërmëdhjetë vjeçe, doja të mësoja të shtypja me makinë shkrimi, prandaj mora një manual që shpjegonte ku të vendosje gishtat dhe kishte disa ushtrime për shtypshkrimin – fjali të shkurtra (dhe më pas më të gjata) të cilët kërkonin që gishtat e tu të arrinin çdo cep të tastierës. Nëna kishte manual të vjetër për të shtypur në një makinë shkrimi, në bodrum, mbetur nga koha kur punonte si sekretare, por s'mu desh ta përdorja për shumë kohë pasi prindërit më blenë një makinë shkrimi elektrike.

Ndërsa fjalitë bëheshin më të gjata, shtypja më shpejt, fillova të kërkoj diçka tjetër për t'u praktikuar. U ushtrova duke shtypur një libër me eseve të Virginia Woolf, jo përmbledhjen e famshme të vitit 1925, Lexuesi i zakonshëm, por një vëllim të vitit 1977 me titullin interesant Librat dhe portretet: disa përzgjedhje nga shkrimet letrare dhe biografike të Virginia Woolf-it. Kjo ishte mrekulli: pjesët e përzgjedhura ishin të shkurtra, por jo edhe aq, kurse gjuha ishte plotësisht përhumbëse, plot fraza të papritura që ishin deri diku në rregull. Për shembull, në një ese mbi biografinë e kohëve

të fundit të një poeti të Luftës së Parë Botërore shkruhej: "Asnjë student i moshës së poetit Rupert Brooke s'do ta kishte vënë re "personalitetin e tij rrezatues, rinor, me petka ku mbizotëronte e kuqja, bluja dhe e arta e ndezur, si një faqe libri të moçëm në një kishëz të Firences; kjo është përshtypja që të krijonte ai burrë i moshuar", shtypa. "Bluja, e kuqja dhe e arta mund të kishin qenë më pak të ndezura, më shumë ishin të përziera, shumëngjyrëshe dhe kjo është çështje për një debat serioz". Edhe tani, të shkruash fraza të tilla të duket sikur krijon muzikë. Mund t'i dëgjoj fjalët ndërsa i shtyp, me një ritëm që ngrihet e ulet, si një zë apo notat e një violine.

U hodha një sy kalimthi skicave të shkurtra letrare të Woolf-it si Në përmishtë ose Kolegji i një gruaje parë nga jashtë, redaktori dukej qartë se donte të theksonte vlerat e esesë së famshme Një dhomë më vete për të arritur tek recensat e librave, shumë prej tyre botuar fillimisht në The Guardian ose Times Literary Supplement në vitet 1910 -1920. Më pëlqeu të shtypurit e esesë mbi ditarët e shkrimtarit të shekullit të

shtatëmbëdhjetë, Samuel Pepys, për të cilin Woolf përshkruan "lehtësinë e pastuduar të gjuhës, e cila mund të jetë e shkujdesur, por gjithmonë ia del të jetë grafike, duke rrokur pareshtur gjendjet e fluturave, kandrrave dhe petaleve në një çast të caktuar". S'i kisha lexuar ende ditarët e Pepys, por Woolf më ngjalli dëshirën t'i lexoja dhe të ndieja se i kisha lexuar, sepse aroma, e distiluar deri në thelbin e zjarrtë dhe përvëlues, si lëngu i jetës, ishte tashmë atje në esenë e saj. Dhe pasi i shtypa – pasi kishin interpretuar dhe unë kisha dëgjuar këngën e tyre, ato ishin tashmë brenda meje, gjithashtu.

Por çfarë ishin këto ese? S'ishin analitike, s'ishin përmbledhje, ato ishin, ndoshta, përgjigje apo edhe kundërpërgjigje, fryt i kontaktit me një libër tjetër. Përveç esëve për shkrimtarët anglezë, kishte disa të tjera për rusët – për Dostojevskin, Turgenievin, Çehovin – dhe disa për shkrimtarë amerikanë – Emerson, Thoreau, Melville. E fundit nga këto botua në 7 Gusht 1919, duke përkujtuar 100 vjetorin e lindjes së Melville më 1 Gusht, megjithëse këtë fakt domethënës s'e vura re kur

shtypa esenë e Woolf-it dyzet vjet më parë – domethënës epse botova një ese për të përkujtuar 200 vjetorin vitin e kaluar. Eseja ime kishte të bënte me romanin Mobi Dik, por eseja e Woolf-it ka të bëjë me veprat e hershme të Herman Melvilit, Typee dhe Omoo; në paragrafin e parë ka një moment të çuditshëm ku Woolf na tregon për diçka që s'e mban mend: "A s'po fliste dikush për detet e Jugut? "Typee", ishte për mendimin e tyre rrëfimi më i mirë shkruar ndonjëherë – në një mënyrë a në një tjetër. Kujtesa ka fshirë gjysmën e fjalisë dhe më pas, siç do kujtesa, ka krijuar një vijë të shkëlqyeshme blu dhe një plazh të verdhë. Ka valë; krijohen deri diku kreshta dallgësh; dhe si ta përshkruash atë që s'e e di, por ka, në të njëjtën kohë, palma, degë gjetheverdha dhe korale në ujin e pastër".

Çfare po ndodh këtu? Kjo s'është analizë, s'është përmbledhje. S'mësojmë asgjë për Typee. Ajo për të cilën mësojmë është reagimi: i vetë Woolf-it, i yni, ndoshta, ndërsa i përgjigjemi linjës rrëfimore të esesë. Këtu, Woolf po ndërton një ese ashtu siç zhvillohej nga William Hazlitt, në fillim të

shekullit të nëntëmbëdhjetë. Ashtu si C.L.R. James, i cili me kujtesën e tij brilante politike, kujtimet për kriketin, Përtej një kufiri pasqyron një reflektim të thellë mbi esetë e Hazlitt-it, veçanërisht ato për boksin – Woolf gërsheton një përmbledhje me sy të lirë të temës së saj me një reagimin vetjak dhe emocional.

Pas këtyre shkrimtarëve shohim dorën aventurore dhe të vetmuar të Montaigne, tre vëllimet e të cilit Esse, u botuan në 1587. Dy vëllimet e para u botuan më herët, më 1580 dhe më 1587. Montaigne shtoi një vëllim të tretë por edhe iu rikthye eseve të mëparshme në përmbledhje – duke hequr disa, duke shtuar disa të tjera, duke i rishikuar disa. Esetë ishin, siç thuhet, punë në proces. Në këtë aspekt, ato ishin një reflektim – ato janë një reflektim – i vetë njeriut.

Montaigne shpjegon se si ai filloi "ese-shkrimin": "Ishte një gjendje shpirtërore melankolike", shkruan ai, "pasojë e errësirës së vetmisë në të cilën isha zhytur disa vite më parë, kjo ishte më e para arsye që më futi në kokë këtë ëndrrën me sy hapur për t'u marrë më të

shkruarit. Dhe pastaj, duke e parë se isha varfanjak dhe i lirë nga çdo gjë, i paraqita vetes për argument dhe temë: “Për dashurinë e etërve për fëmijët e tyre”. Folja në frëngjisht “*essayer*” do të thotë “të provosh”, “të përpiqesh”, madje “të bësh provë”. Ashtu si “provat-bëma” tek *Mobi Dik* i Melville, ku vaji i kulluar i spermës është shkrirë nga copat e balenave të ziera në kazanët e kuvertës së anijes, esetë e Montaigne-s janë një vend ku uni shkrihet në thelbin e saj të kulluar, dhe prapëseprapë Montaigne është ndryshe, në atë që vetja është një kameleon i cili e ndryshon ngjyrën nga e kuqja në blu dhe në jeshile, nga rreshti në rresht, nga faqja në faqe. Uni krijohet dhe ndryshon në kohë reale, ndërsa lexuesi lëviz nëpër ese.

Ne duhet të mendojmë se si përfshirja e shkrimtarëve vendas, duke përfshirë mënyrat e tyre të njohjes, filozofitë dhe mënyrat e tyre të menduarit për formën letrare e prish vetë idenë e “kodit”, të “esesë”, të “letërsisë”. Pavarësisht nga mundësitë dhe liria e mjaftueshme e esesë në duart e Woolf dhe Montaigne, eseja e ditëve tona është bërë e zbutur dhe, urrej ta them, shpesh është jointerese. Eseja me tre pjesë, eseja me pesë pjesë, e cila u mësohet në vitin e katërt të shkollës së mesme dhe filletarëve të kolegjit, është një formulë si rrugë pa krye – një terren i domosdoshëm trajnimi, ndoshta, për të zhvilluar aftësitë e të shkruarit, por pa asgjë të bukur apo të papritur në të. Apo jo? Jam befasuar nga eseja vetëm dy herë.

Hera e parë ishte kur sapo kisha filluar shkollën pasuniversitare në Columbia në fund të viteve 1980, në një seminar mbi “Tekstet e shekullit XVII” me mësimdhënëses Edward Tayler-in. Pavarësisht nga titulli shumë i përgjithshëm, seminari kishte vetëm dy tekste thelbësore: poezitë e John Donne Përvjetori dhe Religio Medici i Thomas Browne, dhe një gamë të gjerë veprash plotësuese, nga Timaeus i Platonit dhe De anima i Aristotelit deri në studimet akademike (të atëhershme) për Historizmin e Ri.

Kam shkruar për metodat e jashtëzakonshme të mësimdhënies së Tayler-it diku tjetër, në një ese mbi shkrimin dhe leximin, por këtu dua të përshkruaj versionin e tij të esesë me tre pjesë. Ai na kërkonte të shkruanim një ese çdo dy javë, duke na bërë të shkruajmë disa ese të shkurtra gjatë semestrit, metodë e cila ishte shumë e ndryshme nga standardi i shkollës pasuniversitare që kërkonte një ese kryesore kërkimore për kurs. Tayler-i na kërkonte të shkruanim një paragraf mbi një fragment të veçantë nga Religio Medici të Browne ose disa rreshta nga një prej poezitë e “Përvjetori” të Donne; një paragraf të dytë për një fragment tjetër nga e njëjta

vepër; dhe pastaj një paragraf të tretë për, le të themi, kohën. Ose unin. Ose vdekjen. Ose të vërtetën.

Thujse s’kishte rëndësi se për çfarë ishte paragrafi i tretë. Gjëja kryesore, ese-shkrimi, ndodhte midis dy paragrafëve të parë dhe të tretit. Ky ishte një lloj kapërcimi imagjinar në të panjohurën, ku do të gjeje diçka, diçka të fshehur, madje as s’e dije se si mund të dukej; mund të ishte me ngjyra të ndezura, do të ishte e gjallë, kjo ishte gjithçka që dije. Herën e parë që shkrova një nga esetë e Tayler-it, u shqetësova shumë, duhet ta pranoj, nga formati. S’e kisha idenë se si të kaloja nga e veçanta – leximet tekstore të paragrafëve një dhe dy – tek e përgjithshmja (koha; vetvetja; vdekja; e vërteta). Na kishte thënë në klasë, sidoqoftë, se vetëm duhej të fillonim të shkruanim për atë gjë të përgjithshme, duke u mbështetur në atë që kishte ndodhur në dy paragrafët e parë për të mbështetur përgjithësimet dhe paragrafi i tretë do të vinte. Dhe kështu ndodhte – me një shpërthim befasues të vëzhgimeve interesante, lidhjeve të papritura dhe fjalëve gati muzikore.

Hera e dytë që u befasova nga eseja ishte para disa javësh, kur lexova përmbledhjen me ese të vitit 2019 Format e jolettrares vendase: ese të shkrimtarëve bashkëkohorë, redaktuar nga Elissa Washuta dhe Theresa Warburton. Hyrja e tyre, e titulluar “Enë të brishta”, paraqet një rrëfim rrënjësisht të ndryshëm të asaj që mund të jetë eseja – çfarë mund të bëjë ese-shkrimi. Duke ndjekur Montaigne, ata e pranojnë se “të shkruash ese do të thotë të provosh, të testosh dhe të praktikosh”. “Forma e esesë”, atëherë, “është një vend i përshtatshëm për punën vëzhguese dhe ndonjëherë të dhimbshme të kërkimit të përgjigjeve”. “Ena e brishtë” është si forma e esesë, ashtu edhe procesi nëpërmjet të cilit krijohet.

Ndërsa ky akt i ese-shkrimit mund të kuptohet brenda një linje standarte, me qasje evropiane – Montaigne, Hazlitt, Woolf – Washuta dhe Warburton qëllimisht e paraqesin përmbledhjen në aspektin e vendit, duke e rrënjësuar në tokat autoktone të ishullit Turtle (Amerikë e veriut). Duke u mbështetur në gjuhën e Montaigne-s për të përshkruar esenë (“të provosh, të testosh dhe të praktikosh”), dhe ndërsa secila prej esëve në përmbledhje është shkruar nga një autor i veçantë, individualiteti si i tillë s’duket të jetë në ballë të asaj që po praktikohet këtu. “Ena e brishtë” mund të dalë nga duart e një mjeshtri të vetëm, por pas këtij individi është një botë e lidhur me të – njerëzore, kafshësh dhe bimësh – dhe një tokë e veçantë.

Parathënia shpalos konceptin e “enës së brishtë” duke e krahasuar me thurjen e një

shporte. Do të ishte e gabuar ta kuptonim këtë shportë si metaforë apo edhe alegori për esenë, apo edhe për aktin e ese-shkrimit: është shumë më tepër se kaq. Washuta dhe Warburton kërkojnë “të përmbysin procesin e kolonizimit” në mënyrë që letërsitë vendase të shihen dhe lexohen si “proces i çkolonizimit”. Ky proces paraqitet si një akt thurjeje, esetë janë shporta, kolektivisht, ato përcjellin formën e enës së brishtë. Ju gati mund t’i shihni gërshetimet, degëzimet dhe rrënjët.

Megjithatë, këto ese, këto shporta, s’janë të gjitha shembuj të një forme të vetme. Disa prej tyre ngajnë me “shportën e molusqeve”, e cila ka hapësira të gjera midis rrënjëve të



ndërthurura të kedrit nëpër të cilat rrjedhin uji dhe rëra ndërsa molusqet qëndrojnë në shportë, disa ngajnë me “shportën e dendur”, të thurur aq fort sa të mbajë ujë, ndërsa të tjerat thuren së bashku “përdridhen dhe bashkohen”. Shumëllojshmëria pasqyron gamën e kombeve ose përkatësive fisnore të përfaqësuara nga kontribuesit, si dhe natyrën e tyre individuale, dhe secila shportë i shërben në mënyrë të përsosur natyrës së vendit nga buron – lumë i rrëmbyeshëm ose breg oqeanik, pyll ose shkretëtirë. Individi dhe bashkësia ku jeton, vendi dhe toka, koha që ikën, të gjitha bëhen bashkë në enën e brishtë, e cila është edhe një (shporta) edhe shumë (secila lloj shporte). Washuta dhe Warburton tregojnë për shportën e thurur nga plaku Suquamish Ed Carriere “me të cilën ruajti dhe rrëfeu historinë e jetës së tij”. Në këtë rast, lënda e shportës ka të bëjë me vendin, ose, ndoshta, kumtet – eseja, secila prej tyre “ka ngjallur

shpesh interes si një objekt antropologjik më shumë sesa si objekt letrar”, dhe megjithatë secila prej tyre qëndron më vete si një enë e brishtë.

Në librin e saj të vitit 2015 Kujtesa shërben, shkrimtarja kanadeze Lee Maracle përshkruan se si njohuria kërkohet kolektivisht, në shumë komunitete rrënjëse (indigjene). Njerëzit mblidhen në një rreth – ose në një seri qarqesh bashkëqendrore, në një grumbull të madh, ku pritët të flasin ata në rrethin më të brendshëm, ndërsa të tjerët veprojnë si dëshmitarë dhe flasin nëse është e nevojshme. Në qendër të rrethit është “ajo që s’shihet, s’dihet, ajo që çmohet dhe fshihet”. Së bashku, përmes një akti të përbashkët të folurit me radhë,

zgjeruar fushën e mësimi dhe studimit të esesë në institucionet akademike të Amerikës së Veriut.

Përkundrazi, një pranëvënie e tillë vë në dyshim vetë bazën e esesë perëndimore, kaq shpesh të marrë si të mirëqenë – dhe të cilën edhe Washuta dhe Warburton e pranojnë, në komentet e tyre si pasardhëse e esesë së Montaigne. Çfarë do të thoshte t’i zhbësh këto hamendësime? Çfarë do të thoshte t’i afrohesh asaj gjëje që çmohet dhe fshihet në mënyrë kolektive, të përbashkët, si kundërvënie ndaj brendakëqyrjes individuale që krijon pjesën e tretë të esesë, në klasën e Tayler-it? Çfarë do të thotë të shkruash ese – të provosh, të testosh – të dyja?

Së fundi, çfarë do të thoshte të çkolonizosh kodin, konkretisht, kodin e shkrimit të esesë që e vë Montaigne në themele dhe përshkruan Woolf në kulm? Washuta dhe Warburton hapin një shteg për “procesin e çkolonizimit” përmes rrëfimit për “enën e brishtë”. Megjithatë duhet të kujtojmë gjithashtu se çkolonizimi s’është metaforë; ka të bëjë me tokën dhe ujin, me gjëra reale në botën reale. Bëhet fjalë për dëmshpërblime, vetëqeverisje dhe autonomi. Ne, me këtë nënkuptoj të ardhurit, ata që s’janë vendas në këto territore – duhet të jemi të gatshëm të heqim dorë nga shumë gjëra për të përqaftuar çkolonizimin.

Çfarë do të kërkonte kjo nga ne, për sa i përket kodit letrar? A mund t’i mbajmë Montaigne dhe Woolf, edhe pse përqafojmë “enën e brishtë”? Kur përfshijmë shkrimtarët vendas në kodet eurocentrike, s’mjafton thjesht të shtojmë disa shkrimtarë. Duhet të mendojmë se si përfshirja e shkrimtarëve autoktonë – përfshin mënyrat e tyre të njohjes, filozofitë dhe mënyrat e tyre të menduarit rreth formës letrare – përfshin vetë idenë e “kodit”, “esesë”, dhe “letërsisë”. Kjo pyetje e domosdoshme është një nga ato që ne bëjmë në bisedat për letërsinë: çfarë do të thotë të kesh një kod? Çfarë përfshihet dhe çfarë përjashtohet? Cilat vepra pranëvihen? Kush flet, dhe kur? Kush dëgjon? Çfarë do të thotë të jesh dëgjues aktiv, dëshmitar, krahasuar me një joaktiv? Çfarë ndikimi mund të kenë tek ne librat – jo vetëm një, por sëbashku?

Nëse imagjinojmë rrethin e përshkruar tek Kujtesa shërben, mund të themi se i kam shtuar diçka – qoftë edhe disa pyetje – përpjekjes sonë të përbashkët për t’iu afruar asaj që është “e fshehur dhe e çmuar”, ndërsa qarkullojmë librat që duam, esetë që lexojmë. Washuta dhe Warburton, me autorët e tyre, kanë kontribuar shumë në këtë përpjekje. Prandaj dëgjoni me kujdes, bëhuni dëshmitar, nëse keni diçka për të shtuar, lexues, shtojeni. Ne vetëm mund të rrekemi, të provojmë ese-shkrimin, së bashku. /Exlibris.al/ Përktheu: Granit Zela

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

THELLOHET KRIZA E LLAPIT DHE E PRISHTINËS



Llapi dhe Prishtina kanë pësuar humbje të dielën dhe në këtë mënyrë janë zhytur në krizë të thellë. Llapjanët pësuan humbjen e dytë radhazi dhe të gjashtë në kampionat, kurse Prishtina pësoi në Drenicë humbjen e tretë radhazi

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Të dielën është mbyllur java e dhjetë në Superligën e Kosovës në futboll. Skuadra e Llapit vazhdon të zhgënjëjë me rezultat që po arrin në këtë edicion, pasi në "Zahir Pajaziti" u mposht nga Drita (1-2), duke e regjistruar humbjen e dytë radhazi dhe të gjashtë në këtë edicion garash. Futbollistët e drejtuar nga Tahir Batatina e mbyllën pjesën e parë me epërsi të një goli, të cilin e realizoi Valmir Veliu. Kampionët nga Gjilani nuk u dorëzuan dhe arritën ta barazojnë rezultatin në minutën e 58ë, kur Almir Ajzeraj realizoi për 1-1. Në minutën e 71-të, Ahmed Januzi realizoi autogol për t'i siguruar fitoren Dritës, e cila në maksimum po synon të mos e lejojë shkëputjen e madhe të Ballkanit. Pas kësaj xhiroje, Llapi është në vendin e parafundit me vetëm 5 pikë, kurse Drita është e dyta me 19 pikë, por ka dy ndeshje më pak të zhvilluara. Në Skenderaj, Prishtina e pësoi humbjen e tretë radhazi. Kryeqytetasit u mposhtën nga Drenica me rezultat 1-0. Në pjesën e parë Prishtina kishte disa raste shënimi që nuk i shfrytëzuan Oto John dhe Alban Shillova, kurse vendësit në minutën e 60 shënuan golin e fitores nëpërmjet zëvendësuesit Egzon Fazliu. Pas dhjetë xhrove të

zhvilluara, Drenica është e pesta me 14 pikë. Prishtina renditet e gjashta me 11 pikë, por ka një ndeshje më pak të zhvilluar.

Formën e mirë ka vazhduar Ballkani i Ismet Munishit, pasi ka mposhtur Besën e Pejës me rezultat 4-1. Sulmuesi më i mirë në ligë, Mirlind Daku, shënoi dy gola në pjesën e parë, derisa Meriton Korenica dhe Egzon Sinani realizuan nga një gol në pjesën e dytë për therandastit. Golin e nderit për pejanët e shënoi Donart Sheqerolli.

Fitore me përmbysje shënoi të shtunën Trepça '89 kundër Arbërisë (1-2). Për vendasit në pjesën e parë shënoi Dior Zabergja, kurse për mysafirët në pjesën e dytë shënuan Bismarek dhe Nimani. Ndeshja tjetër derbi e kësaj xhiroje në mes të Gjilanit dhe Feronikelit përfundoi baras (0-0).

Pas tri humbjeve radhazi të Prishtinës, Ramadani paralajmëron dorëheqje

FC Prishtina ka regjistruar të dielën humbjen e tretë radhazi. Pas kësaj humbje, trajneri Zekirija Ramadani ka paralajmëruar se mund të japë dorëheqje. "Dhamë maksimumin, por nuk mjaftoi që të fitonim. Drenica na mposhti pas angazhimit që kishte. Tri humbje radhazi janë shumë dhe

dikush duhet të marrë përgjegjësi. Ai që duhet të marrë përgjegjësi jam unë dhe nuk i ik përgjegjësisë. Këto tri humbje nuk ngajnë aspak dhe unë do ta marr përgjegjësinë. E them me plotë bindje. Motivimi nuk është në nivelin e duhur, por çfarë do të ndodhë ia lëmë kohës dhe do të flasim me drejtuesit e klubit", ka thënë Ramadani.

SUPERLIGA

Drenica - Prishtina	1-0
Llapi - Drita	1-2
Gjilani - Feronikeli	0-0
Arbëria - Trepça '89	1-2
Ballkani - Besa	4-1

Tabela

1. Ballkani	10	25 pikë
2. Drita	8	19
3. Gjilani	10	17
4. Trepça '89	10	14
5. Drenica	10	14
6. Prishtina	9	11
7. Feronikeli	10	10
8. Arbëria	10	11
9. Llapi	9	5
10. Besa	10	5

Në xhiron e radhës takohen:
Besa-Drenica, Trepça '89-Drita,
Prishtina-Arbëria, Feronikeli-Ballkani,
Gjilani-Llapi.

SHKURT

Hamiltoni regjistron suksesin e 9-të sezonal në Imola

Suksesi i 9-të sezonal për Lewis Hamiltonin në Imola, ndërsa Mercedesi realizoi dopietën e 5-të në këtë kampionat botëror pasi triumfoi në pistën e Emilia-Romagna dhe u kompletua me vendin e 2-të të Valteri Bottas. Gara në Itali u mbyll në diktatin e makinës së sigurisë "Safety Car", pas aksidentit të Max Verstappenit. Në shkallën më të ulët të podiumit në Imola u ngjit Daniel Ricciardo me Renault, ndërkohë që vetëm i 5-ti Charles Leclerc pas krahëve të Danyil Kvyat. Vetëm i 13-ti Sebastian Vettel i tradhtuar nga pit-stop i ngadaltë i mekanikëve të Ferrarit në bokse.

Seferi mposhtet nga rusi Gassiev

Nuri Seferi është mposhtur në raundin e parë nga rusi Gassiev. Kjo ishte goditja e fuqishme e tij. Boksieri shqiptar ka pësuar humbje në ndeshjen me rusin Gassiev. Boksieri rus Murat Gassiev e ka mundur me nokaut boksierin shqiptar Nuri Seferin. Pa kaluar as dy minuta në raundin e parë të takimit, Gassiev i dha një goditje të fuqishme Seferit të cilin e rrëzoi në tokë. Ishte ende raundi i parë dhe vetëm dy minuta të kaluar, kur Gassiev ia dha një grusht të fuqishëm që e rrëzoi në tokë. Seferi u ngrit më pas, por gjyqtari vendosi ta ndërpresë ndeshjen.

Broja vazhdon me gola në Holandë

Armando Broja ka realizuar gol në Holandë, ndërsa Vitesse fitoi 3:1 si mysafire e Willem II. Ndeshja i takoi xhiros së shtatë të Eredivisie të Holandës. Broja, që te Vitesse është huazuar nga Chelsea, realizoi golin e dytë në minutën e 63-të. Vitesse zë vendin e dytë me 18 pikë pas 7 xhrove sa i ka edhe lideri Ajaxi. Për Brojën është goli i katërt i realizuar këtë edicion në Eredivisie.

Gattuso vazhdon kontratën me Napolin

Rino Gattuso ka vendosur ta vazhdojë aventurën te Napoli duke pranuar rinovimin e kontratës. Trajneri do të firmosë deri në vitin 2023 me pagën që do të rritet nga 1,4 milion euro që përfiton aktualisht në sezon në 1,9 milion euro plus bonuset që janë të lidhur me objektivat duke filluar nga pozicionimi në Ligën e Kampionëve e deri te fitimi i trofeve. Heqja e klauzolës prej 7 milionë eurosh në rast ndërprerjeje të njëanshme të kontratës nga ana e trajnerit ka rezultuar përcaktuese në bisedimet mes palëve për arritjen e pajtimit. Napoli i ka besuar projektit të Gattusos dhe me ish-mesfushorin e Milanit në stol synon të arrijë suksese gjatë një periudhe afatgjatë.

Todt: Schumacheri dhe unë shikojmë TV së bashku

PIERREFORT, 1 NËNTOR - Presidenti i FIA-s, Jean Todt, është një nga të paktët që e di se si po shkon gjendja shëndetësore e Michael Schumacherit. Që nga ai aksident fatal i vitit 2013, kur po skijonte, pak dihet mbi kampionin e madh të Formula

1, por ish-shefi i tij i Ferrarit ka folur edhe një herë mbi situatën e Michaelit, si po ecën gjendja shëndetësore e shtatë herë kampionit botëror. Presidenti e viziton rregullisht “Kaiser”, me të cilin arriti sukses të paparë të “Ferrari”: “Lufta e

Schumacherit vazhdon, së bashku me familjen dhe mjekët e tij”, ka thënë Todt për “De Telegraaf”. Jean ka siguruar se është ende në kontakt me të dhe familjen e tij, por nuk ka dashur të komentojë nëse Michaeli është në dijeni të sukseseve që

djali i tij, Mick, po korr në Formula 2: “E takoj Michael rregullisht. Ne shikojmë TV së bashku. A është në dijeni të sukseseve të djalit, Mick? Unë nuk do të flas për këtë. Nuk dua të hyj në detaje, sepse është gjë private”.



Na mungojnë golat e Messit

BARCELONË, 1 NËNTOR - Me barazimin ndaj Alavesit shkoi në katër numri i ndeshjeve pa fitore për Barcelonën në La Liga. Një moment delikat ky për skuadrën blaugrana që pranohet edhe nga trajneri Ronald Koeman të cilin më shumë sesa gabimet e gjyqtarëve e shqetësojnë problemet në finalizim që ka skuadra e tij. Aktualisht blaugranat pozicionohen në vendin e 12-të të renditjes me 8 pikë dhe janë në pozita të vështira pasi Real i Madridit që ka zhvilluar një ndeshje më shumë ka 8 pikë më tepër, ndërsa Atletico Madridi me të njëjtin numër ndeshjesh sa edhe Barça ka 6 pikë më shumë. “Jam i shqetësuar për performancën që bëme në sulm. Nuk bëhet fjalë për përqendrim, por duhet të tregohemi më të kujdesshëm përpara portës. Është pikërisht ajo që na ndodhi edhe kundër Juventusit. Ne krijuam shumë raste, por shënuam vetëm një. Madje pësuam dhe një gol. Diçka nuk shkon”, ka thënë Koeman. “Nuk isha shumë i kënaqur me lojën e pjesës së parë. Ishte e komplikuar sepse ato po na i mbyllnin të gjithë hapësirat. Bëra tre ndërrime,



pasi ritmi ynë duhej të ishte më i lartë. Edhe pse në pjesën e dytë kishim më shumë raste, ne sërish nuk i shfrytëzuam”, ka shtuar Koeman. Trajneri holandez foli edhe për Leo Messin, i cili ka shënuar vetëm dy gola në katër ndeshjet e fundit. “Jam i shqetësuar se në katër ndeshjet e fundit kemi marrë vetëm dy të tilla. Mendoj se loja jonë në përgjithësi ka qenë e pranueshme, por duhet të tregohemi më cinikë para portës. Sigurisht që na mungojnë golat e Leos, janë ato goditje që mund t’i cilësoj si finale para se topi të përfundojë

në rrjetë”, ka deklaruar ai. Ronald Koeman ka kërkuar nga lojtarët e tij që t’i provojnë goditjet jashtë zonës së rreptësisë, pasi hapësira për të bërë një gjë të tillë në ndeshjen e fundit kundër Alavesit nuk ka munguar por, për fat të keq, nuk u shfrytëzua. “Ndonjëherë mendoj se e kërkojmë shumë pasimin e fundit, kur shumë mirë mund të godasim nga jashtë zonës. Hapësira ekzistonte në mes, por ishte e komplikuar. Duhet të gjes kohën dhe momentin e duhur kur të provosh diçka të tillë”, ka përfunduar Koeman.

Peja mposhti Rahovecin

PEJE, 1 NËNTOR - KB Peja ka shënuar fitoren e dytë radhazi në elitë, duke mundur Rahovecin me rezultat 84:64 (24:23, 22:16, 14:14, 24:11), në kuadër të javës së dytë të Superligës së Kosovës në basketboll. Ndeshja ishte shumë interesante nga fillimi dhe në çerekun e parë u zhvillua lojë e barabartë, duke bërë që kjo pjesë të përfundojë me rezultat 24:23. Por, në periudhën e dytë, pejanët ishin më të mirë, duke pasur epërsi dhe këtë 10-minutësh e përfunduan në të mirë të tyre 22:16, duke shkuar në pushim me shifrat 46:39. Perioda e tretë ishte tërësisht e barabartë 14:14, kurse rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 60:53. Në 10 minutat e fundit, vendësit dominuan totalisht dhe thelluan epërsinë, ku këtë pjesë e fituan



24:11, duke triumfuar në fund me rezultat 84:64. Te Peja u dalluan Drilon Hajrizi me 28 pikë e nëntë kërcime dhe Dardan Berisha me 19 pikë e tetë kërcime, kurse te

Rahoveci u dalluan Marvin Jones me 27 pikë dhe Isaiah Traylor me 25. Peja ka dy fitore në dy ndeshje, kurse Rahoveci një fitore dhe një humbje.

Ish-trajneri i Barçës: Messi është i vështirë për ta menaxhuar

Ish-trajneri i Barcelonës, Quique Setien, ka thënë se Lionel Messi është i vështirë për t’u menaxhuar për shkak të reputacionit të madh që ka.

Setien kishte marrë drejtimin e Barcelonës në janar, kur klubi shkarkoi Ernesto Valverden, por ish-trajneri i Real Betisit qëndroi në krye të katalanëve vetëm

gjashtë muaj, para se të lirohej nga detyra në muajin gusht. “Mendoj se Messi është më i miri i të gjitha kohëve”, ka deklaruar Setien. “Ka pasur lojtarë të tjerë

të mëdhenj që kanë qenë të mirë, por vazhdimësinë që ka pasur ky djalë përgjatë viteve, nuk e ka pasur askush. Leo është i vështirë për t’u menaxhuar.

Kush jam unë për ta zëvendësuar atë, nëse ata e kanë pranuar atë siç është ndër vite dhe nuk e kanë ndryshuar”, ka shtuar Setien.

SHKURT

Federeri rikthehet në janar

Tenis i zviceran Roger Federer ka njoftuar se pas një kohe të gjatë është e mundur të rikthehet në fushat e tenisit. Ai bëri me dije se pret të shërohet nga lëndimi në fillim të janarit të vitit 2021. “Shpresoj të jem në gjendje të kthehem në fushë në janar. Ndihej mirë, jam i shëndetshëm, të gjithë në familjen time janë të shëndetshëm”, ka thënë Federer. “Jam në humor të mirë. Kam bërë përparim. Ndoshta jo nga dita në ditë, por nga java në javë me siguri. Është një përparim i mirë. Unë kam qenë në fushë tenisi javën e kaluar, për herë të parë që nga shkurti. Është inkurajuese. Unë punoj sa më shumë që mundem ose aq sa ma lejon gjuri”, ka shtuar Federeri.

Fernandes: Unë dhe Pogba mund të bëjmë gjëra të mëdha në United


Ylli i Manchester Unitedit, Bruno Fernandes, ka thënë se ai dhe Paul Pogba mund të kenë shumë sukses së bashku me skuadrën nga “Old Trafford”. Fernandes beson se me Pogban jo vetëm që mund të luajnë në një skuadër, por mund ta rritin nivelin e ekipit. “Është gjithmonë një kënaqësi të jem në një ekip me të, sepse unë mund të mësoj shumë prej tij dhe ai mund të mësojë shumë nga unë. Së bashku ne mund të bëjmë gjëra të mëdha”, ka thënë Bruno. “Ne kemi një marrëdhënie të mirë, natyrisht. Të dy flasim italisht, kështu që shumicën e kohës flasim italisht. Unë kam një marrëdhënie të mirë me të brenda dhe jashtë fushe. Ai është një djalë qesharak. Ai gjithmonë dëshiron të bëjë shaka. Unë e njoh atë nga Italia tashmë, por tani kam shansin të jem në një ekip me një fitues të Kupës së Botës”, ka shtuar mesfushori portugez.

Tucheli: Mbappe nuk është i lënduar, por i lodhur

Kylian Mbappe u zëvendësua pak para fundit të ndeshjes mes Paris Saint-Germainit dhe Nantes. Trajneri Thomas Tuchel bëri me dije se ky zëvendësim ndodhi për ta parandaluar lëndimin e yllit francez. “Mendoj se Mbappe nuk e ka nga lëndimi, por më shumë nga lodhja. Tani nuk është koha të rrezikojmë shumë. Shpresoj se nuk do të kemi më lëndime të tjera”, ka thënë Tuchel.

Skriniar kalon koronavirusin, gati për ndeshjen ndaj Realit

Interi merr lajm pozitiv në lidhje me situatën e Milan Skriniarit. Qendërmbrojtësi sllovak më në fund doli negativ për Covid-19 dhe për këtë arsye mund të kthehet në dispozicion të trajnerit Conte. Qëllimi është të jetë pjesë e skuadrës zikaltër për ndeshjen kundër Real Madridit të martën në Ligën e Kampionëve. Skriniar ka qenë pozitiv që nga 8 tetori dhe për këtë arsye kaloi gati një muaj në izolim, në Sllovaki. Mungesa e mbrojtësit qendror, i cili ka shfaqur probleme në fazën mbrojtëse në këtë fillim sezoni, u ndie nga zikaltrit.



Izet Sarajliqi (1930-2002) është një ndër poetët boshnjak më të njohur. Sarajliqi është konsideruar një prej autorëve kryesorë të Evropës Lindore dhe është kandiduar për çmimin Nobel për letërsi. Sarajliqi ka qenë anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Bosnje dhe Hercegovinës. Është vlerësuar me shumë çmime, edhe me çmimin prestigjioz "Alberto Moravia" (2001). Gjatë luftës (1992-1995) refuzoi të largohej nga Bosnja. Në këtë luftë, në të cilën u plagos, humbi dy motrat, Ninën dhe Razën, të cilat përmenden në këtë libër. Poezitë e Sarajliqit janë përkthyer dhe botuar në: italisht, frëngjisht, holandisht, gjermanisht, slovenisht, rusisht, lituanisht, anglisht, turqisht, maqedonisht, spanjisht, në gjuhën polake e në disa gjuhë të tjera të botës, edhe në shqip.




Në parathënien e këtij libri është ky paragraf: *Në Sarajevë, të cilën e deshi shumë dhe me poezi shkruar për të e bëri të njohur në mbarë botën, pothuajse askush nuk e kujton më. Madje asnjë rrugë të këtij qyteti nuk ia dhanë emrin e tij.* Kështu shkruan dhe shpreh shqetësim e bija e poetit, Tamara Sarajliq Slavniq, e cila, në korrespondencat me postë elektronike, na njofton se babai i saj, Izeti, sa ishte gjallë kishte qenë disa herë në Prishtinë, se i donte shumë shqiptarët, se u fliste fëmijëve të vet shumë për qytetet e Kosovës, për takimet që kishte pasur disa herë me poetë shqiptarë në mbledhjet poetike që atëkohë organizoheshin në Kosovë dhe në Maqedoni. Po ashtu, shpreh kënaqësi që, pas librit të parë, *Kërkoj rrugë për emrin tim*, përkthyer në gjuhën shqipe, në fund të viteve '70, nga Azem Shkreli, Enver Gjergjeku, Qerim Ujkani, Ali Podrimja dhe botuar nga Rilindja më 1978, po në shqipe po i përkthehet dhe botohet libri i dytë, *Përmbledhja sarajevase e luftës*. Falënderimet e saj, për shtëpinë tonë botuese dhe për ata shqiptarë që kujdesen për vlera letrare dhe njerëzore, për ata shkrimtarë që i do dhe i kërkon bota, që janë institucione të kujtesës kombëtare, që ua kujtojnë gabimet shteteve dhe udhëheqësve të tyre, janë shumë të njerëzishme dhe janë shumë miqësore. Pas shumë fjalëve të saj për punën tonë, i kemi dërguar në fund këtë fjalë: *Boshnjakët edhe mund ta harrojnë luftën, edhe ta harrojnë Sarajliqin, por ne s'do ta harrojmë kurrë luftën e Bosnjës në vargjet e Izetit; s'do ta harrojmë kurrë masakrën që i është bërë popullit të tij; s'do ta harrojmë kurrë fatin e përbashkët që kishim: ju vetëm atje, ne shqiptarët këtu.*

N. Sh. Armagedoni

4.99 €



PËRMBLEDHJA SARAJEVASE E LUFTËS



IZET SARAJLIQ

Përkthyer: Salajdin Salihu
Shkroi parathënien: Tamara Sarajliq Slavniq



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPSTINA LIPLJAN

Kërkesa për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Vëllezërit Frashëri"

Komuna: Lipjan

Data: 02.11.2020

Pranuar më: 30-10-2020

Primitja: 30-10-2020

Nësimi

Nësimi

Nësimi

Numri i kontratës:

ESIP/SDG/025-CS/1.2

Emri i kontratës:

Trajnim 2, Zhvillim profesional: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie – Trajnim me prezencë fizike

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shfmu "Vëllezërit Frashëri", Lipjan. Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:

- Trajnimit Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie do të vijohet nga pjesëmarrësit-mësimdhënësit me prezencë fizike.

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme.
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatesisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e teknologjisë informative;

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e teknologjisë informative (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: Shfmu "Vëllezërit Frashëri" Lipjan, më së largu deri më datën; 10.11.2020 Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:
Personi kontaktues: Avdi Azemi
Telefoni: 049/ 852 - 692
E-maili: avdiazemi@gmail.com

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPSTINA LIPLJAN

Kërkesa për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Ismail Luma"

Komuna: Lipjan

Data: 02.11.2020

Pranuar më: 30-10-2020

Primitja: 30-10-2020

Nësimi

Nësimi

Nësimi

Numri i kontratës:

ESIP/SDG/024-CS/1.3

Emri i kontratës:

Zhvillim profesional, trajnim 2: Vlersimi i nxënësve bazuar në dëshmi – Trajnim me prezencë fizike

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shfmu "Ismail Luma", Lipjan. Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:

- Trajnimit Vlersimi i nxënësve bazuar në dëshmi do të vijohet nga pjesëmarrësit-mësimdhënësit me prezencë fizike.

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme.
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatesisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e vlersimit të nxënësve;

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e vlersimit të nxënësve (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: Shfmu "Ismail Luma" Lipjan, më së largu deri më datën; 10.11.2020 Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:
Personi kontaktues: Driton Sadiku
Telefoni: 044/ 741 - 608
E-maili: dritoni.sadiku@hotmail.com

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPSTINA LIPLJAN

Kërkesa për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Emin Duraku"

Komuna: Lipjan

Data: 02.11.2020

Pranuar më: 30-10-2020

Primitja: 30-10-2020

Nësimi

Nësimi

Nësimi

Numri i kontratës:

ESIP/SDG/023-CS/1.2

Emri i kontratës:

Zhvillim profesional trajnimit 2: Metodologjitë e reja në mësimdhënie – Trajnim me prezencë fizike

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shfmu "Emin Duraku", Banullë - Lipjan. Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:

- Trajnimit: Metodologjitë e reja në mësimdhënie do të vijohet nga pjesëmarrësit-mësimdhënësit me prezencë fizike.

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme.
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatesisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e metodologjive të reja në mësimdhënie;

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e metodologjive të reja në mësimdhënie (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: Shfmu "Emin Duraku",Banullë - Lipjan, më së largu deri më datën; 10.11.2020 Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:
Personi kontaktues: Hazbi Sahiti
Telefoni: 044/183 - 336
E-maili: hazbi.sahiti@hotmail.com

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Naser Saliu shpall te pavlefshme 4 dëftesa dhe diplomën SHME "Ymer Prizreni" Prizren.

► Xhezahir Krasniqi shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Petrit Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e vitit, I-II SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► "Ndertimi-B" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811424738.

► Bastri Sheqiri shpall të pavlefshme katër dëftesat si dhe certifikatën e shkollës së mesme "7 Shtatori" Prishtinë.

► Shkodran Berovci shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "7 Shtatori" Prishtinë.

► Ali Gaggeri shpall te pa vlefshme diplomën e Sh.M.Ekonomike "Kadri Kusari" ne Gjakovë.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

